

FONDI I PYETJEVE NË LËNDËN E GJUHËS SHQIPE
GJUHËSIA SI SHKENCË, NJOHURI MBI PREJARDHJEN E SHQIPES, FONETIKË,
LEKSIKOLOGJI

Pyetja 1

Shenjat e gjuhës janë:

- A) Formula
- B) Simbole
- C) Simptoma
- D) Ikona

Pyetja 2

Cila prej këtyre veçorive nuk i përket shenjës gjuhësore:

- A) Ka karakter arbitrar
- B) Është materiale
- C) Është lineare
- D) Ka lidhje natyrore me atë që shënon

Pyetja 3

Cili prej këtyre funksioneve nuk i përket gjuhës?

- A) Mjet komunikimi
- B) Bartëse e mendimit
- C) Mjet për prodhimin e tingujve
- D) Tipar i një kombi

Pyetja 4

Cila prej thënieve të mëposhtme nuk përbën tipar të gjuhës?

- A) Gjuha ka karakter shoqëror
- B) Gjuha ka karakter historik
- C) Gjuha ka karakter marrëveshjesor
- D) Gjuha ka karakter natyror (biologjik)

Pyetja 5

Materia tingullore është objekt i studimit të:

- A) Fonetikës
- B) Leksikologjisë
- C) Morfologjisë
- D) Semantikës

Pyetja 6

Cila nga fjalët e mëposhtme nuk është e trashëguar nga indoevropianishtja?

- A) Një
- B) Dhëndër
- C) Mua
- D) Qytet

Pyetja 7

Fjala *qytet* është:

- A) E fondit indoevropian
- B) Huazim latin
- C) Huazim grek
- D) Huazim sllav

Pyetja 8

Cilat fjalë i përkasin burimit grek?

- A) fier, lakër, mokër
- B) bujk, faqe, fëmijë
- C) flok, fqinj, furrë
- D) çekiç, çudit, dobi

Pyetja 9

Cilat fjalë i përkasin burimit grek?

- A) gusht, janar, këmbë
- B) këngë, kokë, kushëri
- C) fllad, gosti, gozhdë
- D) pjepër, presh, qershi

Pyetja 10

Cilat fjalë i përkasin burimit latin?

- A) mik, mjek, prill
- B) mëndafsh, oreks, i pastër
- C) kockë, kovaç, kovë
- A) krahinë, kyç, lopatë

Pyetja 11

Cilat fjalë i përkasin burimit latin?

- A) memec, mërzit, neverit
- B) pronë, tipar, stolis
- C) prind, qytet, penë
- D) oborr, padit, patë

Pyetja 12

Cilat fjalë i përkasin burimit turk?

- A) perde, raki, sahat
- B) marinar, paguaj, timon
- C) trumbetë, vapor, velë
- D) Novoselë, Pogradec, Zagori

Pyetja 13

Cilat fjalë i përkasin burimit turk?

- A) Bogovë, Çorovodë, Gorishtë
- B) çarçaf, pazar, penxhere
- C) bankë, bark, batare
- D) fitoj, karrocë, kushton

Pyetja 14

Cili nga toponimet e mëposhtme nuk shpjegohet me fjalë të shqipes së sotme?

- A) Dardania
- B) Ulqini
- C) Dimali
- D) Apolonia

Pyetja 15

Cili prej këtyre emrave të farefisnisë në gjuhën shqipe është trashëguar nga indoevropianishtja?

- A) teze
- B) hallë
- C) teto
- D) motër

Pyetja 16

Veçori gjuhësor në sistemin gramatikor të gjuhëve indoevropiane ka qenë sistemi:

- A) prej dy gjinish
- B) prej tri gjinish
- C) pa gjini
- D) me vetëm gjininë asnjansë

Pyetja 17 V) 2

Në lidhje me sistemin e lakimit, gjuha shqipe ka ruajtur prej gjuhëve ndoevropiane:

- A) të njëjtin numër rasash
- B) ka shtuar dhe pasuruar numrin e rasave
- C) ka më pak rasa
- D) humbi sistemin e lakimit

Pyetja 18

Cila prej fjalëve të poshtëshënuara, nuk i përket trashëgimisë së fondit indoevropian të gjuhës shqipe:

- A) qoshe
- B) bir
- C) ujk
- D) mjekër

Pyetja 19

Ngulitja e theksit mbi një rrokje të caktuar të temës në gjuhën shqipe është :

- A) indoevropiane

- B) paraindoevropiane
- C) e huazuar vonë
- D) zhvillim i vetë gjuhës shqipe

Pyetja 20

Numërorët e përbërë *tridhjetë, pesëdhjetë, gjashtëdhjetë* etj., janë të trashëguara nga:

- A) sistemi indoevropian
- B) huazime nga latinishtja
- C) zhvillime të vetë shqipes
- D) huazime nga turqishtja

Pyetja 21

Dokumenti parë i shqipes i njohur deri më sot është:

- A) Formula e pagëzimit
- B) Fjalorthi i Arnold van Harfit
- C) Fraza e mallkimit
- D) Meshari i Gjon Buzukut

Pyetja 22

Libri parë shqip i njohur deri më sot, Meshari, është i vitit:

- A) 1462;
- B) 1555
- C) 1504
- D) 1496

Pyetja 23

Familja gjuhësore indoevropiane ka:

- A) 13 degë
- B) 14 degë
- C) 12 degë
- D) 9 degë

Pyetja 24

Gjuha shqipe, në familjen e gjuhëve indoevropiane, bën pjesë në:

- A) Degën e gjuhëve gjermanike
- B) Degën e gjuhëve neolatine
- C) Degën e gjuhëve baltike
- D) Degën ilire

Pyetja 25

Supletivizmi është:

- A) Dukuri e trashëguar nga indoevropianishtja
- B) Dukuri e vetë shqipes
- C) Dukuri huazuar nga gjuha latine
- D) Është zhdukur si dukuri

Pyetja 26

Emërtimi i gjuhës shqipe në dokumentet shkrimore në krye të herës del i përdorur:

- A) si ndajfolje
- B) si emër
- C) si mbiemër
- D) si folje

Pyetja 27

Alfabeti që përdorim sot, është vendosur në:

- A) Komisinë Letrare të Shkodrës
- B) Kongresin e Manastirit
- C) Konsultën e Prishtinës
- D) Kongresin e Drejtshkrimit

Pyetja 28

Me termin “*dialekt*” kuptojmë:

- A) Varietet territorial i gjuhës
- B) Gjuhë e fshehtë
- C) Varietet shoqëror i gjuhës
- D) Gjuha standarde

Pyetja 29

Grupi nistor *vo-* është karakteristikë:

- A) E dialektit geg
- B) E dialektit tosk
- C) E të folmeve kalimtare
- D) E gjuhës standard

Pyetja 30

Sa dialekte ka gjuha shqipe?

- A)3
- B)2
- C)4
- D)6

Pyetja 31

Cili është nënsistemi më i vogël i dialektit?

- A) nëndialekti
- B) e folmja krahinore
- C) idiolekti
- D) e folmja vendore

Pyetja 32

Dallimet dialektore krijohen për shkaqe:

- A) të grupeve sociale
- B) të shpërndarjes hapsinore të folësve të një gjuhe
- C) prejardhjes së ndryshme gjuhësore
- D) përkatësisë etnike të ndryshme të folësve

Pyetja 32

Argotë përbëjnë një varietet:

- A) standard
- B) krahinor
- C) shoqëror
- D) funksional

Pyetja 33

Norma drejtshqiptimore përcaktohet nga:

- A) Struktura fonetike
- B) Struktura morfologjike
- C) Struktura dialektore
- D) Struktura leksiko-semantike

Pyetja 34

Karakteristikë e shqiptimit standard janë:

- A) Zanoret e gjata
- B) Zanoret hundore
- C) Zanoret gojore
- D) Zanoret e shkurtra

Pyetja 35

Ligjërimet të thjeshtë (thjeshtligjërimi) përfshin:

- A) Fjalë me ngjyrimë të forta emocionuese
- B) Fjalë dhe shprehje të mirësjelljes
- C) Respektim të gjuhës standard
- D) Struktura të plota sintaksore

Pyetja 36

Gjuha standarde duhet përdorur në:

- A) letërsinë artistike
- B) të gjitha gazetat dhe revistat
- C) në rrjetet sociale-virtuale (facebook, twitter etj)
- D) në tekstet shkollore

Pyetja 37

Sharjet dhe mallkimet i përkasin:

- A) Ligjërimet libror
- B) Ligjërimi bisedor
- C) Thjeshtligjërimet

D) Asnjërit prej tyre

Pyetja 38

Regjistri gjuhës së zakonshme përdoret:

- A) Nga mësuesit në shkollë
- B) Nga njerëz që njihen mirë me njëri- tjetrin
- C) Nga njerëz që kanë pozicion të ngritur dhe largësi me bashkëbiseduesit
- D) Në fjalime publike

Pyetja 39

Fonetika studion:

- A) Trajtat gramatikore të fjalëve
- B) Veshjen tingullore të fjalëve
- C) Fjalëformimin
- D) Kuptimet e fjalëve

Pyetja 40

Fonema është:

- A) Njësi e pandashme pa kuptim e fjalës
- B) Njësi me kuptim e fjalës
- C) Alofon
- D) Shkronjë

Pyetja 41

Cila nga këto veçori nuk i përket zanores:

- A) Nyjëtohet pa pengesë të ajrit
- B) Ka aftësi rrokjeformuese
- C) Është zhurmë
- D) Është ton

Pyetja 42

Nga pikëpamja nyjëtimore zanoret klasifikohen:

- A) Sipas llojit të pengesës
- B) Sipas pjesëmarrjes të zërit dhe zhurmës
- C) Sipas lëvizjes horizontale dhe pingule të gjuhës
- D) Sipas nderjes të aparatit të folurit

Pyetja 43 V) 2

Zanorja [e] e shqipes standarde është:

- A) E përparme
- B) E mesme
- C) E prapme
- D) Asnjëra prej tyre

Pyetja 44

Bashkëtingëllorja [b] ka këto karakteristika nyjëtimore:

- A) mbylltore e shurdhët, buzore
- B) mbylltore, e zëshme, buzore
- C) mbylltore, e zëshme, hundore
- D) mbylltore, e shurdhët, dhëmbore

Pyetja 45

Bashkëtingëllorja [q] ka këto karakteristika:

- A) mbylltore, e shurdhët, buzore
- B) shtegore, e zëshme, dhëmbore
- C) mbylltore, e zëshme, hundore
- D) shtegore, e shurdhët, qiellzore

Pyetja 46

Cila prej këtyre veçorive nuk ëshstë veçori akustike e tingujve të të folurit:

- A) Lartësia
- B) Forca
- C) Timbri
- D) Hundorësia

Pyetja 47

Te cila prej fjalëve kemi togzanor:

- A) Skuadër
- B) Likuido
- C) Ia
- D) Diell

Pyetja 48

Te cila fjalë kemi diftong?

- A) Ngjyey
- B) Miell
- C) Bjer
- D) Buall

Pyetja 49

Çfarë ndryshimi kombinator ka ndodhur te $m+pas>mbas$?

- A) Disimilim
- B) Metatezë
- C) Asimilim
- D) Elizion

Pyetja 50

Çfarë ndryshimi kombinator ka ndodhur në $shtrëngatë>shtërngatë$?

- A) Disimilim
- B) Metatezë

- C) Epentezë
- D) Epitezë

Pyetja 51

Në cilin prej rasteve ka ndodhur dukuria e elizionit?

- A) Ma dha
- B) Ju dha
- C) Të dha
- D) T'i dha

Pyetja 52

Në cilin rast kemi ndërrim apofonik?

- A) natë- net
- B) shteg-shtigje
- C) bredh-brodha
- D) heq-hiqni

Pyetja 53

Në cilin rast kemi ndërrim metafonik?

- A) hedh-hodha
- B) flas-flet
- C) vjel-vola
- D) rreth-rrathë

Pyetja 54

Në cilin rast kemi palatalizim?

- A) I madh-të mëdhenj
- B) Dhëndër-dhëndurë
- C) Ishull-ishuj
- D) Tret-treste

Pyetja 55

Cila prej këtyre njësive nuk është njësi fonetike?

- A) Fonema
- B) Tingulli
- C) Fjala fonetike
- D) Fraza fonetike

Pyetja 56

Cila prej fjalëve është e patheksuar në frazën “Sot prindërit erdhën në shkollë.”?

- A) sot
- B) në
- C) prindërit
- D) erdhën

Pyetja 57

Pse shqipja konsiderohet gjuhë me theks të lirë?

- A) se theksi në fjalë të ndryshme bie në rrokje të ndryshme
- B) se theksi në fjalë të ndryshme bie në të njëjtën rrokje
- C) se theksi lëviz gjatë eptimit të fjalës
- D) se theksi lëviz gjatë fjalëformimit

Pyetja 58

Në cilin prej rasteve kemi fjalë enklitike?

- A) e bardhë
- B) i tha
- C) lërma
- D) kam punuar

Pyetja 59

Pse theksi i shqipes është i palëvizshëm?

- A) se bie në të njëjtën rrokje gjatë eptimit të fjalës
- B) se mbetet brenda morfemës rrënjë gjatë lëvizjes fonetike të theksit
- C) se gjendet përgjithësisht si theks parafundor
- D) se ndryshimi i vendit të theksit jep një fjalë të re

Pyetja 60

Cila prej fjalëve të mëposhtme ka theks tejfundor?

- A) vizatim
- B) muzikë
- C) kumbulla
- D) kokëmushkë

Pyetja 61

Cila prej këtyre fjalëve nuk ka theks dytësor?

- A) Marrrëveshje
- B) Arkërkues
- C) Luleshitës
- D) Republikë

Pyetja 62

Intonacioni është tipar i:

- A) Frazës
- B) Fjalës
- C) Rrokjes
- D) Fjalës fonetike

Pyetja 63

Theksi logjik lidhet:

- A) Me strukturën sintaksore të fjalisë

- B) Me rendin e gjymtyrëve në fjali
- C) Me vlerësimin e folësit në rrethana konkrete
- D) Me shprehjen e nuancave emocionuese

Pyetja 64

Duke u nisur nga intonacioni dallojmë:

- A) Fjalitë sipas qëllimit të thënies
- B) Fjalitë sipas strukturës sintaksore
- C) Rrendin e gjymtyrëve në fjali
- D) Gjymtyrët kryesore nga ato të dyta

LEKSIKOLOGJI

Pyetja 65

Objekti i studimit të leksikologjisë janë:

- A) trajtat gramatikore të fjalëve
- B) lidhjet e fjalëve në fjali
- C) veshja tingullore e fjalëve
- D) fjala dhe leksiku

Pyetja 66

Shenja gjuhësore ka si tipar:

- A) karakterian material
- B) lidhjen natyrore me atë që shënon
- C) është vetëm formë
- D) është vetëm përmbajtje

Pyetja 67

Veçori e fjalës është:

- A) struktura e mbyllur
- B) kuptimi jo i mëvetësishëm
- C) theksi logjik
- D) theksi emocionues

Pyetja 68

Ka kuptim leksikor tërësor dhe të mëvetësishëm:

- A) fjala
- B) morfema
- C) fonema
- D) sintagma

Pyetja 69 V) 1

Ka strukturë të mbyllur:

- A) togfjalëshi

- B) fjala
- C) fonema
- D) morfema

Pyetja 70

Ka vlerë semantike:

- A) fjala
- B) fjalia
- C) kuptimi
- D) koncepti

Pyetja 71

Ka aftësi fjalëformuese:

- A) fonema
- B) kuptimi
- C) koncepti
- D) fjala

Pyetja 72

Në bazë të vlerës paradigmaticke fjalët grupohen në:

- A) në klasa e kategori sipas formës dhe përmbajtjes
- B) në fjalë me kuptime të drejtpërdrejta dhe të figurshme
- C) në klasa sipas ngjyrimit emocionues
- D) në klasa sipas sipas lidhjes me fjalët e tjera

Pyetja 73

Cila prej njësive të mëposhtme është njësi njëfjalëshe?

- A) Duke e lexuar
- B) Kam punuar
- C) Në shkollë
- D) Që sot

Pyetja 74

Cila prej fjalëve është shërbyese?

- A) Të gjatë
- B) Krahë
- C) Kudo
- D) Me

Pyetja 75

Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë emërore?

- A) burri i botës
- B) (e kam) bukë e djathë
- C) u bë erë
- D) anës e anës

Pyetja 76

Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë emërore?

- A) s'e çon kokën
- B) (u bë) gazi i botës
- C) ëndrra në diell
- D) qiçra në hell

Pyetja 77

Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë mbiemërore?

- A) gozhdë në zemër
- B) i hurit dhe i litarit
- C) la kockat
- D) i kreh bishtin

Pyetja 78 V) 2

Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë mbiemërore?

- A) gur në opingë
- B) stan me lepuj
- C) daulle e shpuar
- D) i mori shpirtin

Pyetja 79

Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë foljore?

- A) këmbëza e urës
- B) ia mbylli derën
- C) derë më derë
- D) fill e për pe

Pyetja 80

Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë foljore?

- A) kockë e lëkurë
- B) s'e prish gjakun
- C) pikë loti
- D) qiçra në hell

Pyetja 81

Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë ndajfoljore?

- A) flakë për flakë
- B) kërcu mbi samar
- C) petulla me ujë
- D) e solli në vete

Pyetja 82

Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë ndajfoljore?

- A) e solli vërdallë
- B) qiçra ne hell
- C) kodra pas bregut
- D) tund derën

Pyetja 83

Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë foljore?

- A) tund derën
- B) stan me lepuj
- C) shpirt njeriu
- D) të zitë e ullirit

Pyetja 84

Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë foljore?

- A) i bëj sytë katër
- B) thelë mbi bisht
- C) daulle e shpuar
- D) ha bukën e të përmbys kupën

Pyetja 85

Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë foljore?

- A) i pret goja
- B) teneqe e shpuar
- C) pike loti
- D) me gjak të ftohtë

Pyetja 86

Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë foljore?

- A) ia futi këmbët në një këpucë
- B) me një këmbë në varr
- C) fol e qesh
- D) qesh e ngjesh

Pyetja 87

Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë ndajfoljore?

- A) brez mbi brez
- B) zbardh dhëmbët
- C) nuk ha shqip
- D) pret hollë

Pyetja 88

Cila nga njësitë frazeologjike ka vlerë ndajfoljore?

- A) fill e për pe
- B) u vuri fshesën

- C) i ra prapa
- D) e la pas

Pyetja 89

Fjala *kusi* është një:

- A) historizëm
- B) arkaizëm
- C) dialektalizëm
- D) neologjizëm

Pyetja 90

Fjala *dyrrotak* është një:

- A) historizëm
- B) arkaizëm
- C) dialektalizëm
- D) neologjizëm

Pyetja 91

Fjalë që kanë kuptim të afërt ose të njëjtë janë:

- A) sinonime
- B) antonime
- C) homonime
- D) fjalë polisemike

Pyetja 93

Fjalët *këmbë njeriu-këmbë ure-këmbë tryeze*, kanë lidhje:

- A) sinonimie
- B) polisemie
- C) homonimie
- D) antonimie

Pyetja 94

Fjalët *verë (stinë e vitit) –verë (pije)*, kanë lidhje:

- A) sinonimie
- B) polisemie
- C) homonimie
- D) antonimie

Pyetja 95

Fjalët *mace-micë*, kanë lidhje:

- A) sinonimie
- B) polisemie
- C) homonimie
- D) antonimie

Pyetja 96

Fjalët *rreth* (figurë gjeometrike) –*rreth* (unazë), kanë lidhje:

- A) sinonimie
- B) polisemie
- C) homonimie
- D) antonimie

Pyetja 97

Fjala *gjella* (me kuptimin “jeta”) është një:

- A) historizëm
- B) arkaizëm
- C) dialektalizëm
- D) neologjizëm

Pyetja 98

Fjala *mësonjës* është një:

- A) historizëm
- B) arkaizëm
- C) dialektalizëm
- D) neologjizëm

Pyetja 99

Fjala *fëshfërin* është një:

- A) fjalë onomatopeike
- B) eufemizëm
- C) huazim
- D) neologjizëm

Pyetja 100

Fjala *qoftëlargu* është një:

- A) onomatope
- B) eufemizëm
- C) huazim
- D) neologjizëm

Pyetja 101

Fjala *sabah* është një

- A) huazim
- B) arkaizëm
- C) dialektalizëm
- D) neologjizëm

Pyetja 102

Fjalët *mësues-dhaskal* kanë lidhje:

- A) sinonimie

- B) polisemie
- C) homonimie
- D) antonimie

Pyetja 103

Fjalët që shkruhen njësoj, por nuk kanë lidhje kuptimore janë:

- A) polisemike
- B) homonimike
- C) antonime
- D) sinonime

Pyetja 104

Lidhja kuptimore e fjalëve me kuptim të kundërt është:

- A) polisemi
- B) homonimi
- C) antonimi
- D) sinonimi

Pyetja 105

Aftësia e fjalës për të pasur njëkohësisht shumë kuptime quhet:

- A) polisemi
- B) homonimi
- C) antonimi
- D) sinonimi

Pyetja 106

Fjalët *qepa* (folje)-*qepa* (perime) janë:

- A) homophone
- B) homografe
- C) homoforma
- D) homonime të plota

Pyetja 107

Në cilin rast nuk kemi antonime?

- A) vesh-zhvesh
- B) i ëmbël- i hidhur
- C) mirë-keq
- D) ngrihem-s'ngrihem

Pyetja 109

Në cilin rast nuk kemi sinonime?

- A) i vjetër-i lashtë
- B) ndikim-influencë
- C) derrkuc-gic
- D) mirë-jo keq

Pyetja 110

Nga se dallohen sinonimet *shoh-vështroj-vërej*?

- A) denduria e përdorimit
- B) ngjyrimi emocionues e stilistik
- C) nuanca kuptimore
- D) aftësia për të krijuar fjalë e njësi frazeologjike

Pyetja 111

Me studimin e stileve funksionale merret:

- A) morfologjia
- B) stilistika gjuhësore
- C) sintaksa
- D) leksikologjia

Pyetja 112

Stili i letërsisë artistike karakterizohet nga:

- A) përdorimi i termave
- B) fjalët kryesisht me kuptim të drejtpërdrejtë
- C) përdorimi i fjalëve me kuptim të figurshëm
- D) përdorimi i periudhave me shprehje lidhëzore

Pyetja 113

Fjalët e tipit *forum, seksion* janë karakteristikë e stilit:

- A) teknik-shkencor
- B) politiko-shoqëror
- C) administrative-juridik
- D) të letërsisë artistike

Pyetja 114

Cilit stil i përket pjesa e mëposhtme: “*Morfologjia merret a) me studimin e formave të ndryshme të që marrin fjalët gjatë përdorimit dhe të kuptimeve të këtyre fjalëve; b) me klasifikimin e fjalëve në kategori leksiko-gramatikore, që quhen pjesë ligjërare; c) me tipat kryesorë të fjalëformimit.*”

- A) teknik-shkencor
- B) politico-shoqëror
- C) administrative-juridik
- D) të letërsisë artistike

Pyetja 115

Cila nga këto fjalë nuk është term gjuhësor?

- A) morfemë
- B) sintagmë
- C) e ndryshme
- D) folje

Pyetja 116

Cila prej shprehjeve të mëposhtme është njësi frazeologjike?

- A) Kush e ul qafën, i bien zverkut.
- B) I marri i bën udhë të dehurit.
- C) Si kripa në sy
- D) I urti të vret me pambuk.

Pyetja 117

Kalket frazeologjike mund të jenë:

- A) Përkthime fjalë për fjalë të shprehjeve të huaja frazeologjike
- B) Me burim nga gjuha amtare
- C) Huazime frazeologjike
- D) Përshtatje e shprehjeve të huaja frazeologjike

Pyetja 118

“Happy end” është:

- A) Kalk frazeologjik
- B) Huazim frazeologjik
- C) Njësi frazeologjike
- D) Kompozitë

Pyetja 119

Kalku frazeologjik “thembra e Akilit” është me burim nga:

- A) Bibla
- B) Mitologjia
- C) Historia, filozofia
- D) Ndërtime thjesht gjuhësore

Pyetja 120

“Curriculum vitae” është:

- A) Kalk frazeologjik
- B) Huazim frazeologjik
- C) Njësi frazeologjike
- D) Kompozitë

MORFOLOGJI

Pyetja 121

Cila prej këyre njësive nuk është njësi ndërtuese?

- A) Grupi sintaksor
- B) Fjala
- C) Morfema
- D) Fonema

Pyetja 122

Cila prej këyre njësive ka kuptim tërësor dhe të mëvetësishëm?

- A) Morfema
- B) Grupi sintaksor
- C) Fjala
- D) Fonema

Pyetja 123

Cila prej këtyre formave gramatikore është formë sintetike?

- A) Lis-i
- B) Kam dhënë
- C) Do të punoj
- D) I nënësit

Pyetja 124

Cila prej këtyre formave gramatikore është formë analitike?

- A) Shoh-0
- B) Pashë
- C) Parë
- D) Duke parë

Pyetja 125

Për ndarjen e fjalëve në pjesë ligjërate mëshitetemi në:

- A) Kriterin leksikor
- B) Kriterin morfologjik
- C) Kriterin sintaksor
- D) Në të trija bashkë

Pyetja 126

Pasthirrma është fjalë:

- A) Emërtuese
- B) Thirrmore
- C) Numëruese
- D) Jokuptimplote

Pyetja 127

Cila prej pjesëve të ligjëratës është pjesë e ndryshueshme?

- A) Ndajfolja
- B) Numërori
- C) Lidhëza
- D) Pjesëza

Pyetja 128

Cila prej pjesëve të ligjëratës është pjesë e pandryshueshme?

- A) Ndajfolja

- B) Folja
- C) Emri
- D) Mbiemri

Pyetja 129

Cila nga fjalët e mëposhtme është fjalë e mëvetësishme?

- A) Në
- B) Se
- C) Yll
- D) Dot

Pyetja 130

Cila nga fjalët e mëposhtme është fjalë e pamëvetësishme?

- A) i ri
- B) të gjithë
- C) sepse
- D) çfarë

Pyetja 131

Morfema është:

- A) njësia më e vogël e kuptimshme e fjalës
- B) njësia më e vogël pa kuptim e fjalës
- C) njësi kumtuese
- D) njësi e mëvetësishme

Pyetja 132

Në cilin rast kemi trajta të së njëjtës morfemë?

- A) Ullishtë-ullishte
- B) Rri-ndenja
- C) Unë-mua
- D) Djeg-dogj/a

Pyetja 133

Cila prej njësive të kuptimshme nuk është morfemë?

- A) Tema morfologjike
- B) Rrënja
- C) Ndajshtesat
- D) Mbaresat

Pyetja 134

Te fjala *punoj*, pun- është:

- A) Tema e fjalës
- B) Rrënja e fjalës
- C) Tema morfologjike e fjalës
- D) Tema fjalëformuese e fjalës

Pyetja 135

Te fjala *ëndërrimeve*, tema morfologjike është:

- A) Ëndërrim
- B) Ëndërrime
- C) Ëndërr
- D) Ëndëroj

Pyetja 136

Te fjala *rrofshin*, tema e fjalës është:

- A) Rro
- B) Rrofsh
- C) Rrofshin
- D) Rrofsha

Pyetja 137

Te fjala *burr-a, -a* është:

- A) Mbaresë
- B) Prapashtesë trajtformuese
- C) Prapashtesë fjalëformuese
- D) Rrënjë

Pyetja 138

Në sa morfema ndahet fjala *përpunojmë*:

- A) 3
- B) 4
- C) 5
- D) 6

Pyetja 139

Në sa morfema ndahet fjala *kryeqytetas*:

- A) 3
- B) 4
- C) 5
- D) 6

Pyetja 140

Në sa morfema ndahet fjala *atdhedashurinë*:

- A) 3
- B) 4
- C) 5
- D) 6

Pyetja 142

Cila është mbaresa e fjalës *kuptuam*:

- A) nuk ka
- B) -m
- C) -am
- D) -uam

Pyetja 143

Cila është rrënja e fjalës *zbathur*:

- A) mbathur
- B) zbath
- C) z-bath
- D) zbatha

Pyetja 144

Cila është fjala rrënjë e çerdhes së fjalëve *i papunë-punoj-ripërpunim*?

- A) punë
- B) puno
- C) përpunoj
- D) punim

Pyetja 145

Cila prej fjalëve është e parme?

- A) gjëgjëzë
- B) matje
- C) fushë
- D) bregdet

Pyetja146

Te fjala *çlirimtarëve*, ë-ja është:

- A) prapashtesë fjalëformuese
- B) prapashtesë trajtëformuese
- C) mbaresë
- D) asnjë prej tyre

Pyetja 147

Cila është tema e fjalës *rivlerësimeve*?

- A) rivlerëso
- B) rivlerësim
- C) rivlerësime
- D) Vlerë

Pyetja148

Në fjalën *lisave*, pjesa e fjalës *lisa* është:

- A) temë e parme
- B) rrënja e fjalës
- C) tema fjalëformuese

D) tema morfologjike

Pyetja 149

Fjalët e prejardhura formohen me anë të:

- A) ndajshtesave
- B) bashkimit të temave kuptimplota
- C) konversionit
- D) paranyjëzimit

Pyetja 150

Cila mënyrë fjalëformimi është me prejardhje?

- A) konversioni
- B) kompozimi
- C) përngjitja
- D) pa ndajshtesa

Pyetja 151

Fjala *përgënjeshtroj* është fjalë e prejardhur:

- A) me parashtesë
- B) me prapashtesë
- C) me conversion
- D) me parashtesë dhe prapashtesë njëkohësisht

Pyetja 152

Cila prej fjalëve të mëposhtme është fjalë e prejardhur e tipit prapashtesor?

- A) lexim
- B) i pavlefshëm
- C) kujtojnë
- D) afër

Pyetja 153

Cili prej bashkimeve të mëposhtme nuk është kompozitë (fjalë e përbërë)?

- A) vajtje-ardhje
- B) paradite
- C) OSBE
- D) bregdet

Pyetja 154

***I përpiktë* është fjalë:**

- A) e përngjitur
- B) e përbërë
- C) e prejardhur
- D) e formimit të përzier

Pyetja 155

Konversioni është:

- A) lloj morfeme
- B) mënyrë fjalëformimi
- C) tip fjalëformimi
- D) asnjë prej tyre

Pyetja 156

Cili prej këtyre emrave është abstract?

- A) Lule
- B) Natë
- C) Shtëpi
- D) Ndërtesë

Pyetja 157

Cili prej këtyre emrave është emër përmbledhës?

- A) Djemuri
- B) Gratë
- C) Fëmijëri
- D) Djalëri

Pyetja 158

Emrat përmbledhës janë të formuar:

- A) Me përngjitje
- B) Me kompozim
- C) Me prapashtesim
- D) Parashtesim

Pyetja 159

Emrat përmbledhës përdoren vetëm:

- A) Vetëm në njëjës
- B) Vetëm në shumës
- C) Me numërorë
- D) Për dukuri abstrakte

Pyetja 160

Emrat e lëndës emërtojnë:

- A) Lëndë homogjene
- B) Njësi të numërueshme
- C) Tërësi frymorësh
- D) Dukuri atmosferike

Pyetja 161

Cila nga pikat e mëposhtme është kriter për dallimin e gjinisë së emrave në gjuhën shqipe:

- A) tingulli fundor i temës

- B) mbiemrat dhe fjalët e tjera përcaktuese
- C) mbaresat rasore të së pashquarës dhe të së shquarës njëjës
- D) të gjitha

Pyetja 162

Cili është emër i dygjinishëm (ambigjen)

- A) term
- B) vajzë
- C) det
- D) libër

Pyetja 163

Si dallohet gjinia tek emrat e frymorëve?

- A) me anë prapashtesash
- B) me mënyrën leksikore
- C) me mënyrën leksikore dhe me anë prapashtesash
- D) me mënyrën leksikore, me anë prapashtesash dhe me ndërrime të tingujve të temës

Pyetja 164

Fjala *mish* në njësinë frazeologjike “*Iu ngjeth mishtë*” është:

- A) në gjininë femërore
- B) në gjininë mashkullore
- C) në gjininë asnjëanëse
- D) ambigjen

Pyetja 165

Cila prej fjalëve është në gjininë asnjëanëse?

- A) I qeshur
- B) Të qeshurit
- C) E qeshura
- D) Pa qeshur

Pyetja 166

Emri *Eleni* është në gjininë:

- A) Femërore
- B) Mashkullore
- C) Asnjëanëse
- D) Ambigjen

Pyetja 167

Si e ndërtojnë shumësin këta emra: *lot, nxënës, shtëpi, muze, qen, deve*:

- A) me ndërrim të tingujve të temës
- B) njësoj si njëjësi
- C) me prapashtesë
- D) me ndërrim të tingujve të temës dhe me prapashtesë

Pyetja 168

Si e ndërtojnë shumësin këta emra: *shteg, breg, lak*:

- A) me ndërrim të tingujve të temës
- B) njësoj si njëjësi
- C) me prapashtesë
- D) me ndërrim të tingujve të temës dhe me prapashtesë

Pyetja 169

Si e ndërtojnë shumësin këta emra: *libër, fletore, klasë*:

- A) me ndërrim të tingujve të temës
- B) njësoj si njëjësi
- C) me prapashtesë
- D) me ndërrim të tingujve të temës dhe me prapashtesë

Pyetja 170

Si e ndërtojnë shumësin këta emra: *dash, djalë, mik*:

- A) me ndërrim të tingujve të temës
- B) njësoj si njëjësi
- C) me prapashtesë
- D) me ndërrim të tingujve të temës dhe me prapashtesë

Pyetja 171

Cilët nga këta emra përdoret vetëm në numrin njëjës?

- A) Gjon
- B) Njeri
- C) Djalë
- D) Popull

Pyetja 172

Cilët nga këta emra përdoret vetëm në shumës?

- A) Qelqurina
- B) Mollë
- C) Grari
- D) Shi

Pyetja 173

Cilët nga këta emra përdoret vetëm në numrin njëjës?

- A) ethe
- B) rubeolë
- C) pantallona
- D) të lashtat

Pyetja 174

Cilët nga këta emra përdoret vetëm në shumës?

- A) syze
- B) mirësi
- C) drizëri
- D) lëng

Pyetja 175

Cilat janë mbaresat e rasës dhanore të emrave të gjinisë femërore në trajtën e shquar të numrit njëjës:

- A) -s, -së, -ës, -es
- B) -së, -ës
- C) -e, -je
- D) -s, -së, -ës

Pyetja 176

Cilit lakim i përkasin emrat: *fëmijë, dajë, axhë*:

- A) lakimit të parë
- B) lakimit të dytë
- C) lakimit të tretë
- D) asnjërit prej tyre

Pyetja 177

Cilit lakim i përkasin emrat: *të qeshurit, të zitë, të ngrënë*?

- A) lakimit të parë
- B) lakimit të dytë
- C) lakimit të tretë
- D) lakimit të katërt

Pyetja 178

Sipas kuptimit leksikor, mbiemrat: *i rrufeshëm, i gurtë, i sotëm*, janë:

- A) marrëdhëniorë (të ndërmjetuar)
- B) cilësorë (të drejtpërejtë)
- C) herë cilësorë, herë marrëdhëniorë, sipas kontekstit
- D) të panyjshëm

Pyetja 179

Mbiemrat ditëgjatë, jetëshkurtër, ekonomiko-shoqëror, janë formuar me:

- A) konversion
- B) kompozim
- C) përngjitje
- D) paranyjëzim

Pyetja 180

Kur mbiemrat e panyjshëm vendosen pas emrave, nuk kanë kategorinë e:

- A) gjinisë
- B) numrit

- C) rasës
- D) asnjë prej tyre

Pyetja 181

Kur mbiemrat e panyjshëm vendosen pas emrave, kanë kategorinë e:

- A) gjinisë
- B) numrit
- C) shkallës
- D) rasës

Pyetja 182

Cili prej mbiemrave në fjalitë e mëposhtme është në shkallën krahasore të sipërisë? absolute:

- A) Ato ishin për të ditët më të vështira të jetës.
- B) Dukej jashtëzakonisht i zbehtë, prandaj nuk e ngacmoi më me pyetje.
- C) Rruga m'u duk aq e gjatë, saqë u habita kur i erdhi fundi.
- D) U bë flakë e kuqe dhe nuk nxori dot zë.

Pyetja 183

Mbiemri i bukur në fjalinë: "Sa më shumë kalonte koha, aq më e bukur i dukej ngjarja që kish ndodhur tri ditë më parë", është në shkallën:

- A) pohore
- B) krahasore të barazisë
- C) krahasore të sipërisë relative
- D) sipërore

Pyetja 184

Cili nga pohimet është i vërtetë:

- A) Të gjithë mbiemrat kanë shkallë
- B) Kategoria e rasës të mbiemri është e pavarur
- C) Mbiemri shërben si përcaktues për gjininë e emrit
- D) Mbiemri ka kategorinë e shquarësisë

Pyetja 185

Në cilën prej fjalive të mëposhtme është përdorur përemri dëftor?

- A) Ishte e veçantë ajo ditë.
- B) Në sajë të tij kishin përfutuar të gjithë.
- C) Atyre u dukej sikur edhe netët s'kishin të sosur.
- D) Askush nuk foli për ne.

Pyetja 186

Rrethoni variantin ku nuk ka trajtë të shkurtër të përemrit vetor:

- A) I porositi të kishin kujdes.
- B) Është e vështirë t'u lexosh çdo ditë të njëjtën gjë.
- C) Pas pak kohësh të gjithë u larguam nga ai qytet.

D) Hapeni dritaren, se bën vapë këtu!

Pyetja 187

Përemri *ai* (përkatësisht *ajo, ata, ato*) përdoret:

- A) vetëm si vetor
- B) vetëm si dëftor
- C) si vetor dhe si dëftor
- D) si vetor, si dëftor dhe si i pacaktuar

Pyetja 188

Përemri *i tillë* është:

- A) përemër pronor
- B) përemër lidhor
- C) përemër dëftor
- D) përemër i pacaktuar

Pyetja 189

Përemri pronor *ime* i gjinisë femërore formohet nga gjinia mashkullore:

- A) duke ndryshuar nyjën
- B) duke ruajtur trajtën e gjinisë mashkullore
- C) me supletivizëm
- D) mbaresë femërorizuese

Pyetja 190

Në cilin rast fjala *një* është përdorur si përemër i pacaktuar?

- A) Një e një bëjnë dy.
- B) Një nga më të diturit.
- C) Ishte një ditë e bukur.
- D) Janë në një kurs.

Pyetja 191

Në cilin rast fjala *të* është trajtë e shkurtër?

- A) I foli me të butë.
- B) Folëm me të gjithë kohën.
- C) Do të të pyes dhe ty.
- D) Ditë të tilla ishin pak.

Pyetja 192

Rrethoni variantin, ku fjala *kush* është përdorur si përemër i pacaktuar:

- A) Të flasë kush të dojë.
- B) Trokiti kush?
- C) Nuk e di kush erdhi.
- D) Nuk e mora vesh se me kë udhëtove.

Pyetja 193

Në fjalinë "Nga ç'dëgjo, kuptoi se gjithëcka po shkonte mirë", fjala ç' është:

- A) përemër lidhor
- B) lidhëz
- C) përemër i pacaktuar
- D) përemër pyetës

Pyetja 194

Fjala kur përdoret si:

- A) lidhëz
- B) përemër dhe lidhëz
- C) përemër dhe pjesëz
- D) përemër, lidhëz dhe pjesëz

Pyetja 195

Përemri pyetës sa:

- A) ka kategorinë gramatikore të numrit
- B) ka kategorinë gramatikore të rasës
- C) ka kategorinë gramatikore të numrit dhe të rasës
- D) nuk ka kategori gramatikore

Pyetja 196

Fjala një përdoret:

- A) vetëm si një
- B) vetëm si numëror
- C) si një dhe si numëror
- D) si një, si numëror dhe si përemër i pacaktuar

Pyetja 197

Në fjalinë "*Vëllai i saj ishte mjek në atë qytezë*", folja *jam* është:

- A) me vlerë të plotë leksikore
- B) gjysmëndihmëse
- C) ndihmëse
- D) modale detyrimi

Pyetja 198

Cila prej foljeve të mëposhtme është kalimtare:

- A) Nuk lëvizi asgjë nga vendi.
- B) Nga larg dallohej një tym i zi.
- C) Punonte pareshtur gjithë ditën e ditës.
- D) Nga vinte kjo zhurmë e çuditshme?

Pyetja 199

Rrethoni variantin në të cilin folja është në diatezën mesore:

- A) Vezullimet e dritave ishin përhapur në të katër anët.
- B) U thashë të mos vonoheshin.

- C) U kap keq me të.
- D) Këto lule vyshken shpejt.

Pyetja 200

Në cilën diatezë është folja në fjalinë: “Ato u përqaftuan shpejt e shpejt”

- A) mesore
- B) vetvetore
- C) veprore
- D) pësore

Pyetja 201

Nuk është folje e zgjedhimit të tretë:

- A) di
- B) rri
- C) vë
- D) fle

Pyetja 202

Është folje e parregullt josupletive folja:

- A) them
- B) rri
- C) jam
- D) jap

Pyetja 203

Është folje e parregullt supletive folja:

- A) them
- B) dua
- C) vete
- D) jap

Pyetja 204

Në cilën fjali folja *kam*, është pavetore:

- A) Aty ka disa monedha.
- B) Unë kam disa disa monedha.
- C) Ai ka pasur disa monedha.
- D) Ai ka për të marrë monedha.

Pyetja 205

Foljet *mjaullin*, *s'më besohet*, *gjelbëron* janë:

- A) Me vetë të përcaktuar
- B) Me vetë të përgjithësuar
- C) Pavetore
- D) Njëvetore

Pyetja 206

Forma foljore *qeshë mësuar* është në kohën:

- A) e kryer të thjeshtë të dëftores
- B) e kryer të tejshkuar të dëftores
- C) e kryer të kushtores
- D) më se të kryer të dëftores

Pyetja 207

Rrethoni variantin e saktë të së tashmes së habitores të foljes *mësoj*:

- A) mësuakam
- B) mësokam
- C) mësokërkam
- D) mësokësha

Pyetja 208

E kryera e thjeshtë e zgjedhimit jovepror të foljeve ndërtohet:

- A) me foljen ndihmëse jam
- B) me pjesëzën u
- C) me mbaresa karakteristike
- D) me foljen ndihmëse jam, me pjesëzën u dhe me mbaresa karakteristike

Pyetja 209

Forma foljore *me të dalë* është formë e pashtjelluar:

- A) pohore
- B) mohore
- C) paskajore
- D) përcjellore

Pyetja 210

E tashmja e lidhores ndryshon nga e tashmja e dëftores:

- A) nga pjesëza të
- B) nga tema e njësuar për të gjithë tipat e zgjedhimit
- C) nga pjesëza të dhe nga mbaresat e vetës së dytë e të tretë njëjës
- D) nga pjesëza të, nga tema e njësuar për të gjithë tipat e zgjedhimit dhe nga mbaresat e vetës së dytë e të tretë njëjës

Pyetja 211

Në cilën fjali folja *nisem* është në të ardhmen e së shkuarës?

- A) Do të nisej po të vinte në kohë.
- B) Do të nisej pa zbardhur.
- C) Do të nisem në vjen me mua
- D) Do të nisem dhe unë

Pyetja 212

Pjesorja e foljes:

- A) i ka të gjitha kategoritë gramatikore të foljes
- B) nuk ka asnjë kategori gramatikore
- C) ka vetëm kategorinë gramatikore të vetës
- D) ka kategorinë gramatikore të mënyrës, kohës, vetës dhe numrit

Pyetja 212

Në cilën prej fjalive të mëposhtme fjala *larg* është përdorur si ndajfolje:

- A) Nuk jetonte dot larg tyre.
- B) Vinte që larg ajo zhurmë e padurueshme.
- C) Donte të rrinte larg asaj bote të çuditshme.
- D) Larg vendlindjes çdo gjë i dukej e huaj.

Pyetja 213

Cilat ndajfolje nuk janë ndajfolje rrethore:

- A) Ndajfoljet e vendit
- B) Ndajfoljet e kohës
- C) Ndajfoljet e mënyrës
- D) Ndajfoljet e shkakut

Pyetja 214

Cila prej ndajfoljeve në fjalitë e mëposhtme përdoret vetëm në shkallën krahasore:

- A) Pasi kaloi grykën e malit, e mori më shtruar.
- B) Duhej të kishe folur më pak në atë takim.
- C) Nuk e njohu, se nuk e kishte takuar më parë.
- D) U largua pa u përshendetur, por do të kthehej më vonë.

Pyetja 215

Në fjalinë “*E kërkoi rreth një orë, po nuk e gjeti.*” fjala rreth është:

- A) ndajfolje
- B) emër
- C) pjesëz
- D) parafjalë

Pyetja 216

Në cilin variant fjala *ku* është përdorur si ndajfolje lidhore?

- A) Ku mendon se do të arrish me këtë që bëre?
- B) Fusha ku kaluam, ishte e mbushur plot me lulëkuqe.
- C) Po ecte kuturu dhe nuk e dinte ku po shkelte.
- D) Drita e zbehtë dallohej më qartë atje ku dilte tymi.

Pyetja 217

Në cilin variant nuk është përdorur ndonjë parafjalë?

- A) Ecte nxitimthi edhe rrëzës së malit, që të arrinte sa më parë.
- B) Ajo lule buiste vetëm në pranverë faqe kodrës.

- C) Revista dilte nga shtypi krye cdo muaji.
- D) Qëndroi bri meje pa thënë asnjë fjalë.

Pyetja 218

Si janë formuar parafjalët *buzë, rrëzë, majë*?

- A) Pa ndajshesë
- B) Me konversion
- C) Me kompozim
- D) Me përngjitje

Pyetja 219

Cila nga rasat e mëposhtme nuk përdoret me parafjalë:

- A) emërore
- B) gjinore
- C) dhanore
- D) rrjedhore

Pyetja 220

Në cilin rast kemi lokucion parafjalor

- A) rreth e qark botës
- B) i ra botës rreth e qark
- C) rrethi dhe qarku
- D) në asnjë prej rasteve

Pyetja 221

Lidhëzat në fjali:

- A) nuk shprehin asnjë marrëdhënie
- B) shprehin marrëdhënie barazie dhe varësie
- C) shprehin vetëm marrëdhënie varësie
- D) shprehin vetëm marrëdhënie barazie

Pyetja 222

Në fjalinë “*Nuk ishte ndier kurrë më i lumtur se sot*”, lidhëza se është:

- A) bashkërenditëse
- B) nënrenditëse filluese
- C) nënrenditëse krahasore-mënyrore
- D) nënrenditëse shkakore
- ?

Pyetja 223

Në fjalinë “*U pendova që i fola aq ashpër*”, lidhëza që është:

- A) lidhëz rrjedhimore
- B) nënrenditëse filluese
- C) nënrenditëse qëllimore
- D) nënrenditëse shkakore

Pyetja 224

Në fjalinë “*Në di gjë thuaje, ndryshe mos fol.*”, fjala në është:

- A) lidhëz nënrenditëse kushtorë
- B) lidhëz nënrenditëse kundërvënëse
- C) parafjalë
- D) nënrenditëse filluese

Pyetja 225

Në fjalinë “*Qoftë djali, qoftë vajza po vraponin shpejt*”, lidhëza qoftë...qoftë është:

- A) bashkërenditëse veçuese
- B) bashkërenditëse shtuese
- C) bashkërenditëse përmbyllëse
- D) bashkërenditëse shkallëzimi

Pyetja 226

Në cilin variant fjala që është përdorur si pjesëz:

- A) Duhet të nxitoj që të arrij para se të ngryset.
- B) Nuk e kishte kuptuar që në fillim se gjërat do të merrnin të tatëpjetën.
- C) Mendoi që të nisej vetëm, se vendi ishte i rrezikshëm.
- D) Do të shkonte edhe vëllai i saj, që ai e kishte takuar disa herë.

Pyetja 227

Pjesëzat:

- A) kanë kuptim leksikor të pavarur
- B) shprehin marrëdhënie gramatikore
- C) shërbejnë si gjymtyrë fjalie
- D) shprehin ngjyrimë kuptimore plotësuese

Pyetja 228

Pjesëzat gramatikore:

- A) kanë kuptim leksikor të pavarur
- B) shprehin marrëdhënie gramatikore
- C) shërbejnë si gjymtyrë fjalie
- D) shprehin ngjyrimë kuptimore plotësuese

Pyetja 229

Pasthirrmat:

- A) janë fjale që nuk emërtojnë
- B) janë të prejardhura
- C) janë karakteristikë për gjuhën e shkruar
- D) janë gjymtyrë fjalie

Pyetja 230

Onomatopetë:

- A) janë pjesë ligjërata

- B) janë pasthirrma
- C) riprodhojnë tinguj e zëra
- D) shprehin ndjenja a vullnet të folësit

SINTAKSË

Pyetja 231 V)

Objekti i studimit të sintaksës është:

- A) ligjërimi i lidhur
- B) leksikun dhe fjalët
- C) veshjen tingullore të fjalëve
- D) trajtat e fjalëve në ligjërim

Pyetja 232

Fjalët shërbyese dhe ndihmëse në shprehjen e raporteve sintaksore janë:

- A) mjete fonetike
- B) mjete sintaksore
- C) mjete morfologjike
- D) mjete leksikore

Pyetja 233

Togfjalëshi “*pres trenin*” ka marrëdhënie:

- A) objektore
- B) predicative
- C) rrethanore
- D) përcaktore

Pyetja 234

Togfjalëshi “*shirat e vjeshtës*” ka marrëdhënie:

- A) objektore
- B) predicative
- C) rrethanore
- D) përcaktore

Pyetja 235

Togfjalëshi “*shkruaj bukur*” ka marrëdhënie:

- A) objektore
- B) predicative
- C) rrethanore
- D) përcaktore

Pyetja 236

Togfjalëshi “*shtatë vajaza*” është:

- A) Emëror
- B) Foljor
- C) Mbiemëror
- D) Numëror

Pyetja 237 V)

Togjalëshi “shtatë prej vajzave” është:

- A) Emëror
- B) Foljor
- C) Mbiemëror
- D) Numëror

Pyetja 238 V)

Togjalëshi “kjo ditë” është:

- A) Emëror
- B) Përemëror
- C) Mbiemëror
- D) Numëror

Pyetja 239

Togjalëshi “secila prej ditëve” është:

- A) Emëror
- B) Përemëror
- C) Mbiemëror
- D) Numëror

Pyetja 240

Togjalëshi “tepër larg” është:

- A) Emëror
- B) Foljor
- C) Mbiemëror
- D) Ndajfoljor

Pyetja 241

Fjalja “Kthehem pas një ore.” është:

- A) dëftore e mirëfilltë
- B) dëftore thirrmore
- C) nxitëse e mirëfilltë
- D) nxitëse thirrmore

Pyetja 242

Ç’lloj fjalie është: “Më thuaj cili vend të ka pëlqyer më shumë.”

- A) pyetëse tërësore e drejtë
- B) pyetëse tërësore e zhdrejtë
- C) pyetëse e pjesëshme e drejtë

D) pyetëse e pjesshme e zhdrejtë

Pyetja 243

11) Fjalja mohuese “Nuk tha asnjë fjalë” shpreh:

- A) mohim tërësor
- B) mohim të pjesshëm
- C) mohim tërësor të përforcuar
- D) mohim të pjesshëm të dyfishtë

Pyetja 244

Fjalja mohuese “Ata nuk mund të futen” është:

- A) me pjesëza mohuese
- B) mohim i plotë i përforcuar
- C) me përemra të pacaktuar me kuptim mohor
- D) mohim i plotë i thjeshtë

Pyetja 245

Fjalja “Në derë trokitën për së dyti” është:

- A) fjali dykryegjymtyrëshe
- B) fjali njëkryegjymtyrëshe foljore vetore me vetë të përcaktuar
- C) fjali njëkryegjymtyrëshe foljore vetore me vetë të të përgjithësuar
- D) fjali njëkryegjymtyrëshe foljore vetore me vetë të papërcaktuar

Pyetja 246

Fjalja “Është verë” është:

- A) fjali dykryegjymtyrëshe
- B) fjali njëkryegjymtyrëshe foljore vetore me vetë të përcaktuar
- C) fjali njëkryegjymtyrëshe foljore pavetore
- D) fjali njëkryegjymtyrëshe foljore vetore me vetë të papërcaktuar

Pyetja 247

Cila prej fjalive të mëposhtme është fjali njëkryegjymtyrëshe emërore përshkruese?

- A) Nga mëngjesi.
- B) Ditë e nxehtë vere.
- C) Ja universiteti, ja fakulteti.
- D) Në universitet.

Pyetja 248

Cila prej fjalive të mëposhtme është fjali njëkryegjymtyrëshe emërore treguese?

- A) Nga mëngjesi.
- B) Ditë e nxehtë vere.
- C) Ja universiteti, ja fakulteti.
- D) Në universitet.

Pyetja 249

Fjalja “Ku po shkon? -Në shtëpi” është:

- A) fjali e plotë
- B) fjali e paplotë e kontekstit
- C) fjali e paplotë eliptike
- D) fjali e paplotë e situatës

Pyetja 250

Fjalja “Sipas vendit dhe kuvendi.” është:

- A) fjali e plotë
- B) fjali e paplotë e kontekstit
- C) fjali e paplotë eliptike
- D) fjali e paplotë e situatës

Pyetja 251

Cila prej fjalive të mëposhtme është fjali e pagjymtyrëzueshme e pohimit?

- A) Trang, trang, trang.
- B) Errësirë.
- C) Ëhë.
- D) Shëëët!

Pyetja 252

Cila prej fjalive të mëposhtme është fjali e pagjymtyrëzueshme nxitëse?

- A) Trang, trang, trang.
- B) Vërtet?
- C) Ëhë.
- D) Shëëët!

Pyetja 253

Cila prej fjalive të mëposhtme është fjali e pagjymtyrëzueshme të përshëndetjes?

- A) Mirëmëngjes.
- B) Errësirë.
- C) Ëhë.
- D) Shëëët!

Pyetja 254

Në ç’rast, forma e pashtjelluar foljore funksionon si kallëzues foljor i thjeshtë?

- A) Ata janë për t’u lavdëruar për punën e bërë.
- B) U nisën pa zbardhur dita.
- C) Ecnin duke folur vazhdimisht për atë ngjarje.
- D) U bë për t’u martuar.

Pyetja 255

Në cilin rast kemi kallëzues të thjeshtë foljor?

- A) Të ecur që ecën ky!
- B) Uji nuk mund të arrijë deri këtu.

- C) Qielli ishte i kaltër.
- D) Ti ke frikë, unë jo.

Pyetja 256

Në ç'fjali dalloni kallëzues emëror?

- A) Kush je ti?
- B) Ai ishte në shtëpi?
- C) Ishte vendosur në Tiranë.
- D) Ishte ditë e nxehtë vere.

Pyetja 257

Me çfarë është shprehur gjymtyra emërore e kallëzuesit emëror në fjalinë “Kjo është për të qeshur dhe për të qarë.”?

- A) me mbiemër
- B) me togfjalësh
- C) me paskajore
- D) me emër

Pyetja 258

Ç'tip kallëzuesi kemi te fjalia “Pastaj bëlldum në ujë”?

- A) Kallëzues me pjesë të pandryshueshme të ligjëratës
- B) Kallëzues i thjeshtë foljor
- C) Kallëzues emëror
- D) Kallëzues i përbërë foljor

Pyetja 259

Në cilën fjali kryefjala është e shprehur me një emër në trajtë të pashquar?

- A) Dy maçokë laramanë nisën të ziheshin me potere.
- B) Një mjegull e lagësht e bardhë endej poshtë në luginë.
- C) Çdo njeri do ta kishte të vështirë t'i kuptonte ata të dy.
- D) Në stalla kundërmonte erë bari.

Pyetja 260

Me se është shprehur kryefjala në fjalinë “Unë me motrën nuk morëm pjesë”?

- A) me përemër vetor
- B) me emër të shquar
- C) me përemër dëftor
- D) me ndërtime me kallëzues në shumës

Pyetja 261

Përemri vetor i vetës së parë dhe të dytë shumës nuk përdoren:

- A) në fjali njëkryegjymtyrëshe me vetë caktuar
- B) në fjali dykryegjymtyrëshe
- C) në fjali të paplota
- D) në fjali njëkryegjymtyrëshe me vetë të përgjithësuar

Pyetja 262

Ç'funktion luan mbiemri në fjalinë e mëposhtme?

Zëri i tij u bë i çuditshëm në ato momente.

- A) përcaktor me përshtatje
 - B) ndajshim
 - C) përcaktor kallëzuesor
 - D) gjymtyrë emërore e kallëzuesit emëror
- ?

Pyetja 263

Në cilën fjali kemi kallëzues foljor të thjeshtë të ndërlikuar?

- A) Ky lumë po tkurrej e zvogëlohej.
- B) Ditë e natë atje hynin e dilnin shumë njerëz.
- C) Më kanë mbetur në mend sytë e Mitrushit.
- D) M'u ngulën në tru ora gjashtë dhe emri i kinemasë.

Pyetja 264

Ndajfolja në fjalinë e mëposhtme funksionon si:

Rojet e lanë derën e kështjellës hapur.

- A) gjymtyrë emërore e kallëzuesit emëror
- B) rrethanos mënyre
- C) përcaktor kallëzuesor i kryefjalës
- D) përcaktor kallëzor i kundrinorit

Pyetja 265

Përcaktori kallëzuesor mund të shprehet me formë të pashtjelluar

- A) pjesore
- B) paskajore
- C) mohore
- D) përcjellore

Pyetja 266

Ndajshtimi është lloj:

- A) përcaktori
- B) rrethanos
- C) kundrinori
- D) kryefjale

Pyetja 267

Sintagma e nënvizuar në fjalinë e mëposhtme funksionon si:

- C) Kallëzimit me një simbolikë të veçantë në temë dhe strukturë
- D) Rrëfimit të përpunuar deri në detaje artistike

Pyetja 14

Në tregimet diturore Naim Frashëri synon t’u japë fëmijëve:

- A) Njohuri për figura e ngjarje historike
- B) Njohuri për natyrën, gjithësinë dhe shoqërinë
- C) Frymëzim atdhetar
- D) Njohuri për kafshët

Pyetja 15

Një karakteristikë dalluese e poezisë për fëmijë të Naim Frashërit është:

- A) Përdorimi i elementëve shpjegues për gjithësinë dhe natyrën
- B) Thellësia psikologjike e saj
- C) Përdorimi masiv i karaktereve fëmijërorë
- D) Realizmi i theksuar

Pyetja 16

Me vjershat për fëmijë të Naim Frashëri në letërsinë shqipe për fëmijë fillon:

- A) Lëvrimi i poezisë shqipe
- B) Përkthimi dhe përshtatja e letërsisë së huaj
- C) Letërsia didaktike
- D) Lëvrimi i fabulave

Pyetja 17

Në veprën “I vogli Donat Argjendi” të Papa Kristo Negovanit mbizotëron ideja:

- A) E triumfit të së mirës ndaj së keqes
- B) E gëzimit që sjell harmonia familjare
- C) Domosdoshmërisë së edukimit të fëmijëve
- D) Domosdoshmërisë së edukimit me besimin ndaj perëndisë

Pyetja 18

A. Z. Çajupit, në letërsinë për fëmijë, i takon merita:

- A) E lëvritimit e letërsisë humoristike
- B) E përshtatjen origjinale të fabulave të La Fontenit
- C) E thellimin e frymës realiste
- D) Lëvrimin e përrallës

Pyetja 19

Në letërsinë për fëmijë, Ndre Mjeda mund të vëshetrohet si poet:

- A) I frymës romantike
- B) I frymës realiste
- C) I frymës didaktiko-pedagogjike
- D) I frymës fetare

Pyetja 20

Mund të themi se Ndre Mjeda në poezinë e vet u rrek të thellojë:

- A) Frymën romantike
- B) Frymën iluministe
- C) Frymën e modernitetit
- D) Frymën realiste

Pyetja 21

Monologue i plakut te vjersha “Dimni” e Ndre Mjedës është:

- A) Akuzë për gjendjen e varfër
- B) Ankesë për natyrën e egër të stinës
- C) Pamje e natyrës së ashpër
- D) Përshkrim didaktik mbi natyrën dhe jetën

Pyetja 22

Poezia “Lulëkuqja” e Asdrenit karakterizohet si poezi:

- A) Simbolike
- B) Alegorike
- C) Metaforike
- D) Hiperbolike

Pyetja 24

Letërsia shqiptare për fëmijë e viteve tridhjetë mund të klasifikohet si pjesë e:

- A) Letërsisë së Rilindjes Kombëtare
- B) Letërsisë Didaktike dhe Fetare
- C) Letërsisë së Pavarësisë
- D) Letërsisë moderne për fëmijë

Pyetja 25

Revista “Vatra e rinisë” e Vasil Xhaçkës ishte:

- A) Revistë me përkthime
- B) Revistë e për të rritur
- C) Revistë e posaçme për fëmijë
- D) Revistë për të rritur dhe fëmijë

Pyetja 26

Merita e revistës “Vatra e rinisë” qëndron në faktin se në të:

- A) U lëvrua poezia për fëmijë

- B) U botuan përkthime të letërsisë botërore për fëmijë
- C) U botuan përralla shëipe për fëmijë
- D) U lëvrua proza e shkurtër për fëmijë

Pyetja 27

“Tregime të Moçme Shqiptare” i Mitrush Kutelit përfaqëson një vëllim me:

- A) Rrëfime të përunuara të baladave dhe rapsodive
- B) Rrëfime origjinale të Mitrush Kutelit.
- C) Balada dhe rapsodi folklorike
- D) Rëfime të përpunuara të përrallave shqiptare

Pyetja 28

Krijimtaria për fëmijë e Milto Sotir Gurrës vuan nga:

- A) Tone tepruara proapagandistike
- B) Tone didaktike, naive e sentimentale
- C) Tone të thella realiste
- D) Tone romantike

Pyetja 29

Çfarë mbizotëron në skicat për fëmijë të Migjenit?

- A) Tragjizmi
- B) Melankolia
- C) Revolta
- D) Notat vajtuese

Pyetja 30

Çfarë e dallon poezinë për fëmijë të Qamil Guranjakut?

- A) Vlerësimi i lojës
- B) Fryma didaktike
- C) Shfrytëzimi i folklorit
- D) Motivet shoqërore

Pyetja 31

Vepra e M. Kutelit “ Netë shqiptare” është ndërtuar:

- A) Si rrëfim i autorit
- B) Si rrëfim i një personazhi
- C) Si rrëfim i një grupi mërgimtarësh
- D) Si grumbull ngjarjesh të shkëputura

Pyetja 32

Veçori i stilit të M. Kutelit te tregimi “Xha Brahoja i Shkumbanores” është:

- A) Rrëfimi popullor
- B) Muzikaliteti i frazës
- C) Ritmi i brendshëm
- D) Shprehja poetike

Pyetja 33

Gjatë periudhës së Luftës II Botërore në letërsinë shqipe për fëmijë mori më shumë zhvillim:

- A) Kënga për fëmijë
- B) Romani për fëmijë
- C) Përralla
- D) Drama për fëmijë

Pyetja 34

Letërsia shqipe për fëmijë e periudhës së Luftës II Botërore u karakterizua nga:

- A) Fryma propagandistike
- B) Fryma didaktike
- C) Fryma popullore
- D) Fryma realiste

Pyetja 35

Letërsia kosovare për fëmijë është karakterizuar nga:

- A) Larmia e zhanreve
- B) Censura dhe autocensura
- C) Liria tematike
- D) Veçoritë stilistike

Pyetja 36

Në poezinë e Hivzi Sulejmanit “Vendi im i shtrenjtë” me ç’pjesë ligjërate bëhet përshkrimi i bukurisë së atdheut:

I bardhë a vendi im/i bardhë

E lumejtë të shpejtë/t’argjentë

I kaltër a qielli im/i kaltër

E lumejtë të shpejtë/t’argjentë

- A) Mbiemra
- B) Emra
- C) Folje
- D) Përemra pronorë

Pyetja 37

Tregimi i Hivzi Sulejmanit “Këngë” është një tregim mbi:

- A) Heroizmin e popullit të Kosovës nën pushtimin serb
- B) Fisnikërinë dhe krenarinë njerëzore edhe në varfëri
- C) Tregim me motive nga Lufta e Dytë Botërore
- D) Tregim mbi botën e fantazisë fëmijërore

Pyetja 38

Vjershat e vëllimit “ Dita e parë” të autorit kosovar Mark Krasniqi janë:

- A) Mësimore-moralizuese

- B) Zbavitëse-argëtuese
- C) Njohëse-shkencore
- D) Propagandistike

Pyetja 39

Abdylazis Islami në romanin “Hekurani i Artas” trajton si temë kryesore:

- A) Përpjekjet për arsimin shqip në Maqedoni
- B) Vuajtjet dhe përndjekjet ndaj shqiptarëve në Maqedoni
- C) Kushtet e vështira social-ekonomike të shqiptarëve të Maqedonisë
- D) Mitologjinë dhe legjendat

Pyetja 40

Proza e pasluftës e Qamil Guranjakut karakterizohet nga:

- A) Vërtetësia e ngjarjeve
- B) Trillimi artistik
- C) Personazhet imagjinare
- D) Mbështetja në folklor

Pyetja 41

Spiro Çomora, në poezinë e tij për fëmijë, shfrytëzoi:

- A) Mitologjinë
- B) Këngët e rriteve të motmotit
- C) Personazhet e përrallave
- D) Gjëagjëzat

Pyetja 42

Cila është tema mbizotëruese në letërsinë shqipe për fëmijë të viteve 50 të shekullit XX?

- A) E kaluara me ngjarje nga Lufta Nacionalçlirimtare
- B) E kaluara historike
- C) Legjendat
- D) Jeta e përditshme e fëmijëve

Pyetja 43

Poezia shqipe për fëmijë është shkruar përgjithësisht me:

- A) Varg të matur me rimë
- B) Varg të lirë
- C) Varg të thyer
- D) Lloje të ndryshme vargjesh

Pyetja 44

Dinamika e romanit “Shpella e piratëve” të Petro Markos mbahet gjallë nga:

- A) Shpirti aventuresk dhe aksionet energjike të fëmijëve
- B) Rrëfimi i përpunuar deri në detaje
- C) Veprimet e shumta misterioze të personazheve

D) Saktësia historike e romanit

Pyetja 45

Novela-përrallë “Kacamisri” e shkrimtarit Teufik Gjyli përfaqëson:

- A) Një krijim tërësisht fikcional të autorit
- B) Një përrallë me një rrëfim realist
- C) Një përrallë thjesht e ritreguar
- D) Një motiv përralle i zgjeruar dhe i përpunuar kompozicionalisht

Pyetja 46

Vepra “Pushimet e Çufos” e Gaço Bushakës ka si tipar dominant të stilit:

- A) Aventura, peripeci dhe skena humori
- B) Aventura, peripeci dhe veprim dramatik
- C) Ngjarje serioze, por me protagonistë kafshët
- D) Alegorinë e fortë

Pyetja 47

Kompozicioni i romanit “Kalamajtë e pallatit tim” i Bedri Dedes është:

- A) I thjeshtë linear
- B) I fragmentarizuar në pjesë të ndryshme
- C) Mozaik ngjarjesh në gojën e rrëfimitarit
- D) I mbështetur në një linjë të vetme

Pyetja 48

Romani “Guna e zezë” i Bedri Dedes është roman për fëmijë sepse:

- A) Ka personazhe fëmijër
- B) Ka tone didaktike
- C) Është shkruar në përputhje me psikologjinë fëminore
- D) Trajton temë historike

Pyetja 49

Romani “Droja” i Rifat Kukajt dallohet për:

- A) Ndërthurjen e disa linjave
- B) Për subjektin mbi një linjë të vetme
- C) Për ngjarjen të mbështetur në folklor
- D) Për subjektin fantastik

Pyetja 50

Krijimtaria e shkrimtarit Skënder Hasko dallohet për:

- A) Ideologjizimin
- B) Humorin
- C) Realizmin
- D) Thjeshtësinë

j

Pyetja 51

Poema- përrallë e Adelina Mamaqit “Orizi i milingonave”ka në bazë figurën e:

- A) Onomatopesë
- B) Përsëritjes
- C) Aliteracionit
- D) Polisidentit

BAZAT E LETËRSISË BOTËRORE PËR FËMIJË

Pyetja 52

Pse fabulat konsiderohen si lexime për fëmijë?

- A) Sepse kanë stil të thjeshtë dhe kanë moralizim
- B) Kanë vlera njohëse
- C) Kanë vlerë didaktike
- D) Kanë si personazhe figura kafshësh

Pyetja 53

Pse Fedri i quajti fabulat e veta “ezopiane”?

- A) sepse i ndërtoi sipas modelit të fabulave të Ezopit
- B) sepse bëri përshtatje të fabulave të Ezopit
- C) për të rritur rëndësinë e veprës së tij
- D) mori lëndë nga fabulat e tij:

Pyetja 54

Cilën cilësi të karakterit moralizon fabula “Korbi dhe dhelptra”?

- A) Thjeshtësinë
- B) Bujarinë
- C) Mendjemprehtësinë
- D) Mirësinë

Pyetja 55

Cili konsiderohet përshtatësi më i mirë i fabulave të La Fontenit në shqip?

- A) PapaKristo Negovani
- B) Andon Zako Çajupi
- C) Vedat Kokona
- D) Faik Konica

Pyetja 56

Krillovi u dha fabulave të veta:

- A) Karakter politik
- B) Karakter didaktik
- C) Karakter utilitar
- D) Karakter njohës

Pyetja 57

Përrallat “Njëmijë e një net” mendohet të jenë krijuar:

- A) Rreth shekullit XV
- B) Rreth shekullit XIV
- C) Rreth shekullit XVI
- D) Rreth shekullit XIII

Pyetja 58

Kush i përktheu për herë të parë përrallat e “Njëmijë e një netëve” në shqip?

- A) Mustafa Greblleshi
- B) Faik Konica
- C) Naim Frashëri
- D) Andon Zako Çajupi

Pyetja 59

Në çfarë vete zhvillohet përralla e Sinbad Detarit?

- A) Në vetën parë
- B) Në vetën e dytë
- C) Në vetën e tretë
- D) Me folje pavetore

Pyetja 60

Cili i është elementi magjik në përrallën “Ali Baba meë dyzet hajdutë”?

- A) Vrasja e vëllait të Aliut
- B) Fuqia e Morxhianës
- C) Formula “Hapu Susam”
- D) Zbulimi i Ali Babait

Pyetja 61

Me çfarë përngjan udhëtimi i Sinbad Detarit?

- A) Me udhëtimin e Odisesë drejt Itakës
- B) Me udhëtimet e Guliverit
- C) Me udhëtimet e Aladinit
- D) Me udhëtimet e Robinson Kruzosë

Pyetja 62

Johan Amos Komenius (1658) hodhi idenë se:

- A) Librat duhet t’i argëtojnë fëmijët
- B) Librat janë vetëm për të rriturit
- C) Librat janë vetëm për të mësuar
- D) Librat janë vetëm për fëmijë

Pyetja 63

Cili konsiderohet libri i parë klasik për fëmijë?

- A) Robinson Kruzo
- B) Udhëtimet e Guliverit

- C) Emili
- D) Histori të kohëve të shkuara

Pyetja 64

Krijimtaria e klasicizmit u përqëndrua në:

- A) Prozën e gjatë
- B) Prozën e shkurtër
- C) Dramaturgjia
- D) Poezi

Pyetja 65

Veprat sentimentale për fëmijë konsiderohen jo të përshtatshme sepse:

- A) Kanë frymë të theksuar didaktike
- B) Kanë frymë trishtuese me dhimbje e brengë
- C) Janë histori të ndërlikuara
- D) Janë të gjata

Pyetja 66

Përrallat e Charl Perrosë shquhen për:

- A) Frymën e thellë moralizuese
- B) Thjeshtësinë e ideve për moshat parashkollore
- C) Frymën aventureske
- D) Personazhet imagjinarë

Pyetja 67

Cili element i përrallave popullore bie në sy në përrallën e Charl Perrosë “Maçoku me çizme”?

- A) Humori i hollë
- B) Subjekti linear
- C) Figura e maçokut
- D) Hyrja klishe dhe fundi i lumtur

Pyetja 68

Në letërsinë për fëmijë Daniel Defo konsiderohet:

- A) Krijues i romanit fantastik
- B) Krijues i romanit aventuresk
- C) Krijues i romanit realist
- D) Krijues i romanit sentimental

Pyetja 69

Romani “Robinson Kruzo” është bazuar:

- A) Mbi një ngjarje reale
- B) Mbi një trillim artistik
- C) Mbi një ngjarje historike
- D) Në mitologji

Pyetja 70

Personazhi i R. Kruzosë dallohet për:

- A) Dëshirën për aventurë
- B) Shpirtin praktik tregtar
- C) Humanizmin
- D) Prirjen për të filozofuar

Pyetja 71

Romani “Robinson Kruzo” ngjan me përrallat:

- A) Nga rrëfimi i qetë epik
- B) Nga veprimi dinamik
- C) Rrëfimi në vetën e parë
- D) Mungesa e dialogut

Pyetja 72

Romani “Udhëtimet e Guliverit” shquhet për:

- A) Shpirtin e aventurës
- B) Satirën politiko-shoqërore
- C) Elementin fantastik
- D) Realizmin e thellë

Pyetja 73

Humori, ironia dhe sarkazma janë veçori dalluese në stilin e veprës letrare të autorit:

- A) Mark Tuein
- B) Zhyl Vern
- C) Vëllezërit Grim
- D) Daniel Defo

Pyetja 74

Vepra “Robinson Kruzo” e autorit Daniel Defo i kushtohet:

- A) Shpirtit aventuresk dhe aftësisë njerëzore për mbijetesë
- B) Shpirtit aristokrat dhe fisnik
- C) Botës së fantazisë fëmijërore
- D) Botës reale të fëmijëve

Pyetja 75

Të papriturat që i ndodhin personazhit dhe që lidhen me këmbimin e beftë të madhësisë trupore janë pjesë e romanit:

- A) Liza në botën e çudirave
- B) Robinson Kruzo
- C) Aventurat e Tom Sojerit
- D) Zemër

Pyetja 76

Letërsia e gjysmës së parë të shekullit XIX u mbizotërua nga:

- A) Sentimentalizmi
- B) Realizmi
- C) Romantizmi
- D) Fryma filozofike

Pyetja 77

Fryma romantike e letërsisë së gjysmës së parë të shekullit XIX duket në:

- A) Mbledhjen e përpunimin e përrallave
- B) Romanet aventureske
- C) Romanet fantastike
- D) Romanet historikë

Pyetja 78

Zhyl Verni konsiderohet:

- A) Si shkrimtari i parë i rëndësishëm i romanit fantastiko-shkencor
- B) Si shkrimtari i parë i rëndësishëm i romanit aventuresk
- C) Si shkrimtari i parë i rëndësishëm i romanit realist
- D) Si shkrimtari i parë i rëndësishëm i romanit historik

Pyetja 79

Mbi çfarë u mbështet vepra e Eduard Lirit “Një libër i gjërave të pakuptimta”?

- A) Mbi ngjarje reale
- B) Mbi lëndë folklorike
- C) Mbi përmbledhje karikaturash për fëmijë
- D) Mbi poezi fetare

Pyetja 80

Cilëve u takon merita e kthimit të ilustrimeve në formë të veçantë arti?

- A) Ilustruesve amerikanë
- B) Ilustruesve anglezë
- C) Ilustruesve francezë
- D) Ilustruesve italianë
- ?

Pyetja 81

Përrallat e përpunuar nga vëllezërit Grim dallohen:

- A) Për gëshetimin e reales me fantastiken
- B) Mbizotërimin e krijimit mbi origjinalin
- C) Për fjalitë e gjata me më shumë se dy pjesë
- D) Për përshkrime të gjata të natyrës

Pyetja 82

Epoka në të cilën zhvillojnë veprimtarinë Vëllezërit Grim përkon me epokën kur u zhvillua rryma letrare e:

- A) Romantizmit
- B) Realizmit kritik
- C) Iluminizmit
- D) Modernizmit

Pyetja 83

Vëllezërit Grim në përpunimet e përrallave gjermane:

- A) I qëndrojnë besnikë strukturës origjinale të përrallës
- B) Bëjnë ndryshime të dallueshme strukturore
- C) Ritregojnë besnikërisht përrallën
- D) Rikrijnë krejtësisht një përrallë të re vetëm mbi bazën e një motivi

Pyetja 84

Pushkini u dallua për shkrimin:

- A) e përrallave në prozë
- B) e poezive për të rinj
- C) e poemave përrallë
- D) e prozës së shkurtër

Pyetja 85

Hans Kristian Andersen dallohet në gjininë e përrallës për:

- A) Thellimin e frymës realiste
- B) Mbizotërimin e fantastikes
- C) Romantizmin
- D) Sentimentalizmin fetar

Pyetja 86

Përralla “Rrobat e reja të mbretit” është bazuar mbi:

- A) Një përrallë popullore
- B) Një krijim të mirëfilltë
- C) Elementë autobiografikë
- D) Motiv nga subjekt letrar

Pyetja 87

Përralla e Hans Kristian Andersen “Rrobat e reja të mbretit” është një:

- A) Satirë ndaj jetës së mbretërve dhe simpati për gjykimin e njerëzve të thjeshtë
- B) Tregim sentimental për jetën e një vajze
- C) Rrëfim aventuror
- D) Rrëfim me bazë historike

Pyetja 88

A mund të quhet Oskar Uajlld një autor që në rrëfim:

- A) Përziën rrëfimin real me atë fantastik
- B) Moralizon thellësisht nëpërmjet rrëfimit
- C) Krijon një botë tërësisht imagjinare

D) Krijon suspansë nëpërmjet dinamikës së rrëfimeve

Pyetja 89

Romani “Pinoku” ka meritën e kthimit të letërsisë për fëmijë nga:

- A) Fantastike në didaktike
- B) Nga populllore në origjinale
- C) Nga didaktike në artistike
- D) Nga fetare në moralizuese

Pyetja 90

Mbi çfarë figure artistike është mbështetur shprehja “Ah sa sëmundje e keqe qënka uria!” (shkëputur nga romani “Pinoku”)?

- A) Mbi metoniminë
- B) Mbi metaforën
- C) Mbi krahasimin
- D) Mbi sinekdodën

Pyetja 91

Subjekti i romanit “Dy vjet pushime” (Zhyl Vern) fillon me:

- A) Pikën e lidhjes
- B) Pikën kulminante
- C) Parashtrimin
- D) Zgjidhjen

Pyetja 92

Heronjtë e romanit “Dy vjet pushime” janë:

- A) Vetëm fëmijë
- B) Fëmijë dhe të rritur
- C) Fëmijë dhe kafshë
- D) Fëmijë dhe personazhe fantastikë

Pyetja 93

A është romani “Dy vjet pushime” i Zhyl Vernit:

- A) Një roman i aventurës së pastër
- B) Një roman fantastiko – shkencor
- C) Një roman i ndërtuar mbi ngjarje me natyrë historike
- D) Një roman i aventurës dhe fantastiko – shkencorë njëkohësisht

Pyetja 94

“Liza në botën e çudirave” është ndërtuar:

- A) Mbi një fabul moralizuese
- B) Mbi një fabul satirike
- C) Mbi një fabul fantastike përrallash
- D) Mbi një fabul aventureske

Pyetja 95

Tom Sojeri është personazh:

- A) I idealizuar
- B) Aventurier
- C) Fëmijë real
- D) Me tipare të veçanta

Pyetja 96

Romani “Zemër” është ndërtuar si:

- A) Një muzik ngjarjesh në një ditë
- B) Subjekt klasik me një fabul të rrjedhshme
- C) Si një tërësi tregimesh në gojën e mësuesit
- D) Si ngjarje pa lidhje me njëra-tjetrën

Pyetja 97

Romani “Zemër” i Edmond de Amicis është ndërtuar:

- A) Në formën e një mozaiku me copëza të ndryshme
- B) Në formën e një rrëfimi unik dhe koherent
- C) Në formën e një rrëfimi që evokon ngjarjet e një të shkuare të largët
- D) Në formën e një rrëfimi memuaristik

Pyetja 98

Rrëfimi në vetën e parë të romani “Ishulli i thesarit”(Stivenson) lexuesit të vogël:

- A) I jep ndjenjë përjetimi
- B) E bën sositës
- C) E bën autorin
- D) E nxjerr jashtë rrëfimit

Pyetja 99

Përmasat e vogla të Nils Holgersonit e bëjnë personazhin:

- A) Të shijojë botën me gjithë larminë e saj
- B) Të vuajë pasojat e veprimeve të tij
- C) Të ndihet inferior
- D) Të bëhet mik me më të pafuqishmit

Pyetja 100

Nils Holgersoni përfaqëson një:

- A) Personazh të imagjinatës fantastike
- B) Personazh historik
- C) Personazh veprë fantastiko – shkencore
- D) Personazh i përshkruar me realizëm të thellë

Pyetja 101

Piter Pani do që të mbetet fëmijë i përjetshëm sepse:

- A) Do të jetë i përkëdhelur nga të rriturit

- B) Nuk duron dot tutelën e të rriturve
- C) Se i pëlqen të mburret
- D) Se i pëlqen të luajë

Pyetja 102.

Letërsia për fëmijë ka si objekt studimi:

- A) Letërsinë e krijuar posaçërisht për fëmijë të moshave shkollore
- B) Krijimtarinë gojore artistike popullore për fëmijë
- C) Kritika dhe mendimin kritik për letërsinë për fëmijë
- D) Letërsinë për moshat 18-22 vjeç

Pyetja 103.

Letërsia për fëmijë lindi si nevojë e veçantë:

- A) Për plotësimin e letërsisë për të rritur
- B) Për plotësimin e nevojave të mësimin në shkollë
- C) Për një degë të veçantë letërsie
- D) Për plotësimin e letërsisë moralizuese

Pyetja 104.

Cilës prej grupmoshave nuk i drejtohet letërsia për fëmijë:

- A) 3-6 vjeç
- B) 9-12 vjeç
- C) 12-15 vjeç
- D) 16-18 vjeç

Pyetja 105.

Cila krijimtari nuk përfshihet në objektin e letërsisë për fëmijë?

- A) Krijimtaria popullore për fëmijë
- B) Kritika dhe mendimi kritik për letërsinë për fëmijë
- C) Tekstet didaktike (shkollore)
- D) Letërsi që nuk është shkruar për fëmijë, por që ka hyrë në leximet e tyre

Pyetja 106.

Në përralla nuk gjejmë:

- A) Përdorim të pasur të proverbave
- B) Hyrjet dhe mbylljet klishe
- C) Përshkrimet e gjata të natyrës
- D) Vendime veçantë të veprimit

Pyetja 107.

Letërsia për fëmijë karakterizohet:

- A) Si degëe letërsisë artistike të përgjithshme
- B) Si letërsi e veçantë në raport me letërsinë e përgjithshme
- C) Me parime të veçanta artistike nga letërsia për të rritur
- D) Vetëm me parime moralizuese e edukuese

Pyetja 108.

Në shekullin XIX kritikët dhe pedagogët i këshillonin shkrimtarët e letërsisë për fëmijë:

- A) Të merrnin parasysh letërsinë tradicionale për fëmijë
- B) Të shkruanin letërsi moralizuese
- C) Të merrnin parasysh veçoritë psikike të fëmijëve
- D) Të mbështeteshin në arsyttime

Pyetja 109.

Teoria e letërsisë, në fillimet e veta lidhej:

- A) Me metodikat e të mësuarit në shkollat fillore
- B) Me letërsinë për fëmijë si degëmë vete e letërsisë së përgjithshme
- C) Me letërsinë për fëmijë në kuadrin e letërsisë zbavitëse
- D) Me asnjërën prej tyre

Pyetja 110.

Cili prej këtyre emrave lidhet me fillimet e e kritikës letrare për fëmijë me veprën “Didaktika e madhe” (shek.XVIII)

- A) Bjelinski
- B) Pestaloci
- C) Dobrolubovi
- D) Komenski

Pyetja 111.

Cilit prej këtyre kritikëve i përket thënia “Moralizimet kanë kërcënuar dhe kërcënojnë letërsinë për fëmijë. Ai mplekset me me didaktizmin e thatë dhe kthehet në mësim, në vargje.”:

- A) Bjelinski
- B) Pestaloci
- C) Ushinski
- D) Komenski

Pyetja 112.

Sipas shkrimtarëve të shekullit XIX, gjuha e veprave të letërsisë duhet të jetë:

- A) Moralizuese
- B) Me fjalë e shprehje të panjohura për moshën e fëmijëve

- C) E përafërt me gjuhën krijimtarisë popullore
- D) Asnjëra prej tyre

Pyetja 113.

Në letërsinë për fëmijë, cili element jep përshtypjen e gjallë mbi atë që lexohet:

- A) Ilustrimi
- B) Thënia moralizuese
- C) Njohuritë shkencore
- D) Asnjëra prej tyre

Pyetja 114.

Fabula e një veprë letrare është:

- A) Ngjarje nga jeta a të trilluara që shërbejnë si bërthamë e saj
- B) Tërësi ngjarjesh të organizuara si pasqyrim realiteti ku përfshihen karakteret e personazheve
- C) Stili i shkrimit të veprës letrare
- D) Tërësia e figuracionit të veprës letrare

Pyetja 115.

Subjekti i një veprë letrare është:

- A) Ngjarje nga jeta a të trilluara që shërbejnë si bërthamë e saj
- B) Tërësi ngjarjesh të organizuara si pasqyrim realiteti ku përfshihen karakteret e personazheve
- C) Stili i shkrimit të veprës letrare
- D) Tërësia e figuracionit të veprës letrare

Pyetja 116.

Personaliteti i heroit të një veprë letrare për fëmijë gjykohet:

- A) Në bazë të veprimit që kryen dhe si pjesëtar i ngjarjes
- B) Në bazë të veçorive psikologjike të heroit
- C) Në bazë të veçorive emocionale të heroit
- D) Në bazë të karaktereve të personazheve të tjerë

Pyetja 117.

Veprat e A. Gajdarit “Timuri dhe skuadra e tij” dhe “Sekreti ushtarak” dallohen:

- A) Për mjeshtërinë e ndërtimit të fabulës
- B) Për personazhe realë
- C) Për ndërtimin e karaktereve
- D) Për subjektin real

Pyetja 118.

Romani i P. Markos “Shpella e piratëve” është i spikatur:

- A) Për mjeshtërinë e ndërtimit të fabulës
- B) Për personazhe realë
- C) Për ndërtimin e karaktereve
- D) Për subjektin real

Pyetja 119.

Sipas Makarenkos, në veprat për fëmijë ka sukses:

- A) Analiza psikologjike e personazheve
- B) Përshkrimi i formimit gradual të personazhit
- C) Tipate përcaktuar të personazheve
- D) Asnjë prej tyre

Pyetja 120.

Në veprat për fëmijë janë të nevojshme:

- A) Përshkrimet e imëta dhe delikate të natyrës
- B) Përshkrimet e hollësishme të heronjve
- C) Përshkrimet e ndjesive emocionale të heronjve
- D) Përshkrimet e ndërthurura me veprimin

Pyetja 121.

Ligjërimi në vetë të parë është tipar dallues i krijimtarisë:

- A) realiste
- B) humaniste
- C) moderne
- D) klasiciste

Pyetja 122.

Sa gjini letrare dallohen teorikisht:

- A) 2
- B) 3
- C) 4
- D) Shumë

Pyetja 123.

Letërsia dallon nga artet e tjera nga:

- A) përdorimi i fjalës si mjet artistik
- B) funksioni estetik
- C) gjuha e figurshme

D) funksioni njohës

Pyetja 124.

Vjershat lirike që përshkruajnë peizazhe natyrore me elementë të jetës fshatare e baritore quhen:

- A) idile
- B) himne
- C) ode
- D) epigram

Pyetja 125.

Si formë tregimtare “objektive” cilësohet:

- A) lirika
- B) epika
- C) dramatika
- D) satirika

Pyetja 126.

Animizimi është përgjithësisht tipar i:

- A) romanit e poe
- B) dramës klasike
- C) poezisë lirike
- D) përrallës për fëmijë

Pyetja 127.

Cili kriter është përdorur në periodizimin e letërsisë shqiptare për fëmijë:

- A) gjeoëografik
- B) historik
- C) mbi bazën e metodës letrare
- D) të treja bashkë

Pyetja 128.

E vlerësoan folklorin dhe patën marrëdhënie të ngushta me të:

- A) Klasicistët
- B) Simbolistët
- C) Humanistët
- D) Romantikët

Pyetja 129.

Në fjalinë e figurshme “*Lexova Migjenin*”, “*E bleva Kadarenë*” është përdorur:

- A) Krahasimi

- B) Metafora
- C) Simboli
- D) Metonimia

Pyetja 130.

Figura që, me anë të tingujve, imiton dukuri akustike të ndryshme nga natyra, bota e kafshëve, njerëzit dhe dukuritë e tjera natyrore, është:

- A) asonanca
- B) epanalepsa
- C) paralelizmi figurative
- D) onomatopeja

Pyetja 131.

“Është një rrëfim i lidhur me një ngjarje, që e ka zanafillën në kohët më të lashta dhe që lidhet me krijimin dhe prejardhjen e botës, me perënditë e ndryshme dhe besimet fetare, me krijimin e kombeve, gjuhëve, etj.”. Kështu përkufizohet:

- A) përralla
- B) fabula
- C) miti
- D) të treja së bashku

BAZAT E LETËRSISË BOTËRORE PËR FËMIJË

Pyetja 132.

Përrallat e grupimitindian u bënë të njohura në Evropë:

- A) Gjatë kryqëzatave në shekullin XII
- B) Përmes botimeve të përkthimeve të tyre
- C) Gjatë udhëtimeve të indianëve dhe egjiptianëve të lashtë
- D) Gjatë udhëtimeve të shkrimtarëve romantikë në vendet ekzotike

Pyetja 133.

Tregimet popullore evropiane që u quajtën “përralla magjike” e kishin origjinën nga:

- A) Skocia
- B) Anglia
- C) Irlanda
- D) Islanda

Pyetja 134.

Përrallat irlandeze u përkasin viteve:

- A) 400 p.e.s
- B) 400 e.s
- C) 800 e.s.
- D) 200 p.e.s

Pyetja 135.

Në ruajtjen e historive irlandezelujati rol:

- A) Izolimi i Irlandës
- B) Përhapja e shtypshkronjës
- C) Marrëdhëniet tregëtare
- D) Pushtimet

Pyetja 136.

Sa histori popullore irlandeze përcaktoi Xhef Xhekobsi në në përmbledhjen e tij?

- A) 2000
- B) 200
- C) 250
- D) 3000

Pyetja 137.

Përrallat irlandeze (shek.XI-XII) u shkruan në gjuhën:

- A) Galeze dhe irlandeze
- B) Kelte
- C) Angleze
- D) Në asnjërën prej tyre

Pyetja 138.

Cili prej elementëve të mëposhtëm është element shqiptar përrallash:

- A) Fluturimi
- B) Sandalja e humbur
- C) Ora
- D) Prishja e magjisë

Pyetja 139.

Përhapja e motiveve të njëjta të përrallave ka ndodhur si shkak:

- A) Përhapjes së shkrimit
- B) Zhvillimit të arsimit
- C) Zhvillimit teknologjik

D) Transmetimit gojor

Pyetja 140.

Motivet më afër origjinalit të përrallave popullore indiane u transmetuan:

- A) Në rrugë tokësore
- B) Në rrugë detare
- C) Përmes përhapjes së shkrimit
- D) Përmes zhvillimit të teknologjisë

Pyetja 141.

Burimet e shkruara të tregimeve popullore në Evropë datojnë:

- A) Pas shekullit XII e.s
- B) Pas shekullit IX e.s
- C) Pas shekullit XIII e.s
- D) Pas shekullit VIII e.s

Pyetja 142.

Përmbledhja e vetme me përralla e Charl Perosë u botua më:

- A) 1627
- B) 1630
- C) 1729
- D) 1702

Pyetja 143.

Cilit shkrimtar për fëmijë i kushtohet thëniae akademikut francez Pol Hazard: “Ai është plot humor dhe shkathtësi spikatëse. Ai kurrë nuk të lëpërshtypjen se kërkon të presë duartrokitje, por ai duket më i kënaqur se kushdo, kur bashkon gjithë këtë histori vetëm për kënaqësinë vet?”

- A) Sh. Perosë
- B) Xh. Xhekobsit
- C) Vëllezërve Grim
- D) A.M. Afanasievit

Pyetja 144.

Vëllezërit Grim janë të parët:

- A) Në aplikimin e shkencës moderne të folkloristikës
- B) Në mbledhjen e përrallave
- C) Në përshtatjen e përrallave
- D) Në studimin e gjuhës së përrallave

Pyetja 145.

Merita e vëllezërve Grim qëndron në:

- A) Ruajtjen e origjinalitetit të burimit të përrallave
- B) Përshtatjen e përrallave
- C) Mbledhjen e përrallave
- D) Ndryshimin e subjekteve

Pyetja 146.

Botimi përmbledhjes me përralla të vëllezërve Grim u përkthye në:

- A) 16 gjuhë
- B) 17 gjuhë
- C) 10 gjuhë
- D) 8 gjuhë

Pyetja 147.

Botimi i dytë i përmbledhjes me përralla të vëllezërve Grim i përket vitit:

- A) 1855
- B) 1824
- C) 1815
- D) 1823

Pyetja 148.

Përrallat norvegjeze dallohen për:

- A) Natyrën serioze
- B) Përdorim të shpeshtë të rimës
- C) Mungesë humori
- D) Subjekte të gjata

Pyetja 149.

Cila kafshë është shumë e pranishme në përrallat norvegjeze si “simbol i Veriut”:

- A) Ujku
- B) Ariu polar
- C) Foka
- D) Pinguini

Pyetja 150.

Përmbledhja me tregime popullore skandinave (K. Asbjornsen; J.Moe) titullohet:

- A) 1001 net
- B) Përralla dhe legjenda
- C) Lindja ose Dielli dhe Perëndimi ose Hëna
- D) Tregimet e Xhekut

Pyetja 151.

Merita e hartimit të koleksioneve të përrallve nga Xhef Xhekobsi qëndron në:

- A) Mbledhjen e përrallave për arkivat e shoqërisë së folklorit
- B) Përdorimin e menjëheshëm të tyre në argëtimin e fëmijëve
- C) Ruajtjen e përrallave pa ndryshime
- D) Në mbledhjen e përrallave vetëm me burim nga ishulli britanik

Pyetja 152.

Në përmbledhjen e përrallave nga Xhef Xhekobs përfshihen edhe përralla nga:

- A) Australia
- B) Azia
- C) Amerika e Jugut
- D) Afrika

Pyetja 153.

Nëpërrallat e Xhekobsit është i pranishëm:

- A) Ariu polar
- B) Vrasësi gjigand
- C) Këpuca e humbur
- D) Qilimi fluturues

Pyetja 154.

Shprehja “*Hapu Sazam*” i përket përrallës:

- A) Ali Baba me 40 hajdutë
- B) Llamba e Aladinit
- C) Udhëtimet e Simbad Detarit
- D) Hirushja

Pyetja 155.

Përrallat arabe u bënë të njohura në Evropë nga përkthimi frëngjisht i tyre më:

- A) 1704
- B) 1705

- C) 1710
- D) 1713

Pyetja 156.

Përkthimi i përrallave arabe për herë të parë në Evropë u bë në gjuhën:

- A) Gjermane
- B) Angleze
- C) Franceze
- D) Italiane

Pyetja 157.

Përrallat finlandeze konsiderohen të vështira për fëmijët sepse:

- A) Janë të gjata dhe me emra të vështirë personazhesh
- B) Janë të zymta
- C) Kanë subjekte të ndërlikuara
- D) Kanë ngjarje jo të përshtatshme për moshën e fëmijëve

Pyetja 158.

Përrallat ruse konsiderohen jo të përshtatshme për fëmijët sepse:

- A) Janë të gjat dhe me emra të vështirë personazhesh
- B) Janë të zymta
- C) Kanë subjekte të ndërlikuara
- D) Kanë ngjarje të frikshme të përgjakshme

Pyetja 159.

Përrallat e zezakëve të Amerikës konsiderohen:

- A) të kufizuara për shkak të dialektit
- B) të zymta pa humor
- C) të ndërlikuara dhe me shumë personazhe
- D) se kanë ngjarje jo të përshtatshme për moshën e fëmijëve

Pyetja 160.

Cila nga këto kategori nuk bën pjesë në folklorin e SHBA-së:

- A) përrallat nga zezakët e Amerikës
- B) përrallat meksikane
- C) përrallat nga indianët e Amerikës së Veriut
- D) Variante nga përrallat evropiane

Pyetja 161.

Përrallat e Indianëve të Amerikës së Veriut dallohen për:

- A) Për elementë fantastikë fluturimi
- B) Për mizori, gjak e prerje kokash
- C) Për xhinde që plotësojnë dëshira
- D) Për xhuxhë të zgjuar e dinakë

BAZAT E LETËRSISË SHQIPTARE PËR FËMIJË

Pyetja 162.

Cilat nga veprat e mëposhtme të letërsisë për fëmijë nuk është vepër didaktike?

- A) “Gjahu i malësorëve” i Kristoforidhit
- B) Mësimet fillestare të Dh. Haxhiut
- C) “Protopeiria” e Th. Kavaliotit
- D) Vepra didaktike greqisht-shqip e K. Beratasit

Pyetja 163.

Ëvetari i N.Veqilharxhit është:

- A) mirëfilli didaktike
- B) përmbledhje folklorike për fëmijë
- C) vepër gjuhësore për fëmijë
- D) përmbledhje mësimesh fetare

Pyetja 164.

Letërsia për fëmijë e Rilindjes Kombëtare:

- A) u dallua për karakterin fetar
- B) nuk arriti nivelin artistik të letërsisë për të rritur të së njëjtës periudhë
- C) nuk pati frymë realiste
- D) nuk kishte karakter didaktik

Pyetja 165.

Cili nga krijimet e mëposhtme nuk përfshihet në “E këndimit çunavet Këndonjëtorja” të N. Frashërit?

- A) Tregimi dituror
- B) Tregimi atdhetar
- C) Tregime për kafshët dhe marrëdhëniet e tyre me njerëzit
- D) Përshtatje origjinale pjesësh letrare për fëmijë

Pyetja 166.

Skica “Gjahu i malësorëve” i K. Kristoforidhit ka të theksuar:

- A) dialogun e shkurtër
- B) monologun
- C) përshkrimin e natyrës
- D) psikologjinë e personazheve

Pyetja 167.

Në tregimet atdhetare, Naim Frashëri synon t’u japë fëmijëve:

- A) Njohuri për figura e ngjarje historike
- B) Njohuri për natyrën, gjithësinë dhe shoqërinë
- C) Frymëzim atdhetar
- D) Njohuri për kafshët

Pyetja 168.

Një karakteristikë dalluese e poezisë morale për fëmijë të Naim Frashërit është:

- A) Edukimi përmes dijes e punës
- B) Edukimi përmes fesë
- C) Edukimi përmes modeleve
- D) Asnjëra prej tyre

Pyetja 169.

Nëvjershat për fëmijë të Naim Frashëri përmbledhen:

- A) Poezia diturore
- B) Përkthimi dhe përshtatja e letërsisë së huaj
- C) Poezia romantike
- D) Poezia filozofike

Pyetja 170.

Nëvjershat për fëmijë të Naim Frashëri nuk përmbledhen:

- A) Poezia diturore
- B) Përkthimi dhe përshtatja e letërsisë së huaj
- C) Poezia morale
- D) Fabulat

Pyetja 171.

Në veprën “I vogli Donat Argjendi” të Papa Kristo Negovanit vuan nga:

- A) Përshkrimet e gjata
- B) Prirja e tepruar pedagogjike
- C) Fryma e thellë fetare
- D) Gjuha e vështirë plot greqizma

Pyetja 172.

A. Z. Çajupi e botoi “Përralla të zgjedhura nga vjershëtori i madh La Fonten” më:

- A) 1924
- B) 1921
- C) 1912
- D) 1930

Pyetja 173.

Në letërsinë për fëmijë, Ndre Mjeda mund të vështrohet si poet:

- A) Që i këndoi natyrës
- B) Që thuri himne për perëndinë
- C) Që krijoi fabula të mbështetura thellësisht në folklor
- D) Që krijoi vjersha me figuracion të theksuar

Pyetja 174.

L. Gurakuqi në poezinë e vet për fëmijë dallohet për:

- A) Përpjekjet për një varg të rrjedhshëm dhe të përpunuar artistikisht
- B) Frymën iluministe
- C) Moralizimet e gjata
- D) Frymën realiste dhe shpirtin e thellë atdhetar

Pyetja 175.

Skeçet e Gjerasim Qiriazit përbëjnë fillimet e:

- A) Tregimit humoristik për fëmijë
- B) Dramës shqipe për fëmijë
- C) Këngëve për fëmijë
- D) Poezisë humoristike për fëmijë

Pyetja 176.

Poezia “Si po prishet gjuha shqype” e Filip Shirokës karakterizohet si poezi:

- A) Satirike
- B) Alegorike
- C) Metaforike
- D) Hiperbolike

Pyetja 177.

Letërsia shqiptare për fëmijë e viteve 1930 dallohet:

- A) Për individualitete krijuese të spikatura
- B) Për lëvrimin e letërsisë didaktike dhe fetare
- C) Për përkthime nga letërsia botërore për fëmijë

D) Për përmbledhje të veçanta të kësaj letërsie

Pyetja 178.

Përrallat e Faik Konicës janë botuar në gazetën:

- A) “Vatra e rinisë”
- B) “Mituria”
- C) “Albania”
- D) “Fjamuri i arbitrit”

Pyetja 179.

Merita e revistës “Mituria” qëndron në faktin se në të:

- A) U lëvrua kryesisht poezia për fëmijë
- B) U botuan përkthime të letërsisë botërore për fëmijë
- C) U botuan përralla shqipe për fëmijë
- D) U lëvrua proza e shkurtër për fëmijë

Pyetja 180.

“Legjenda e luleve” i Teufik Gjylit përfaqëson një vëllim me:

- A) Rrëfime të përpunuara të baladave dhe rapsodive
- B) Përralla origjinale të autorit.
- C) Kallëzime edukative për fëmijë 10-12 vjeçarë
- D) Rrëfime të përpunuara të përrallave shqiptare

Pyetja 181.

Krijimtaria për fëmijë e Milto Sotir Gurrës përmbledh për herë të parë

- A) Përkthime nga letërsia franceze
- B) Përkthime nga letërsia ruse
- C) Përkthime nga letërsia italiane
- D) Përkthime nga letërsia angleze

Pyetja 182.

Skica “Zeneli” E Mgjenit është shkruar:

- A) Në vetën e tretë
- B) Në stil të rrjedhshëm
- C) Në vetën e parë
- D) Me një shkrimtar narrator

Pyetja 183.

Përpunimi i përrallave nga folklori në nivel noveleështë tipar i tregimtarisë së:

- A) Konicës
- B) Agollit

- C) Kutelit
- D) P. Markos

Pyetja 184.

Revista “Fjamuri i Arbërit” (1885) është themeluar nga:

- A) De Rada
- B) Konica
- C) Koliqi
- D) Asdreni

Pyetja 185.

Bazën folklorike të krijimtarisë së tij M. Kuteli e mori nga:

- A) autorët e letërsisë së vjetër
- B) studimet në Bukuresht e Selanik
- C) folklori ynë
- D) autorët e Rilindjes

Pyetja 186.

Në vargun e Migjenit “Kafshatë që s'kapërdihet asht or vlla mjerimi...” është përdorur:

- A) inversioni
- B) aliteracioni
- C) retorike
- D) epiteti

Pyetja 187.

**Vargjet e Asdrenit: “Lulqkuqeja e mjera A
Asgjékundi s'ka shtëpi B
e shkonjëtën nd'arrati; B
ajo s'është si të tjera A
S'ka stoli”, kanë rimë:**

- A) të kryqëzuar
- B) të përsëritur
- C) të puthur
- D) të anasjelltën

Pyetja 188.

Fabula ka krijuar:

- A) Fishta
- B) Poradeci
- C) Koliqi
- D) Agolli

Pyetja 189.

Te “Rëfime e legjenda për Skënderbeun” Kokë Malçi përfaqëson:

- A) urtësinë popullore
- B) trimin e rrëmbyer
- C) strategun e sprovuar
- D) njeriun e besës

Pyetja 190.

Flamur Topi ka lëvruar letërsinë:

- A) Didaktike
- B) Fantastiko-shkencore
- C) Historike
- D) Asnjë prej tyre

Pyetja 191.

Figura artistike kryesore e romaneve të Flamur Topit është:

- A) Simboli
- B) Alegoria
- C) Animizimi
- D) Metonimia

Pyetja 192.

Pjesa teatrale për fëmijë “Kështjella dhe helmi” e I. Kadaresë ka në qendër:

- A) Fakte historike
- B) Ngjarje të trilluar
- C) Personazhe historikë
- D) Personazhë fëmijë

Pyetja 193.

Kritika letrare e letërsisë për fëmijë mori zhvillim:

- A) Në vitet 30 të shekullit XX
- B) Në periudhën e Rilindjes
- C) Në vitet 44-89 të shekullit XX
- D) Pas viteve 90 të shekullit XX

Pyetja 194.

Karakteristikë e letërsisë për fëmijë në vitet 1944-1989 është:

- A) Pati shkrimtarë posaçërisht përfëmijë
- B) U shkrua letërsi për fëmijë në kuadrin e letërsisë për të rritur
- C) U shmang ideologjia
- D) U zhvillua në gjini të kufizuara

Pyetja 195.

Nga pikëpamja artistike letërsia për fëmijë e viteve 1944-1989 karakterizohet nga:

- A) domosdoshmërisht një hero pozitiv pa të meta
- B) larmi karakteresh me konflikte të brendshme
- C) larmi ngjyrimesh të personazheve
- D) personazhe dinamike në zhvillimin e tyre

Pyetja 196.

Letërsia për fëmijë pas viteve 1990 karakterizohet:

- A) nga vlera e shitjeve në tregun e botimeve
- B) nga cilësia e lartë e shkrimeve
- C) nga përkthime cilësore të letërsisë së huaj
- D) nga shkrimtarë cilësorë për fëmijë

Pyetja 197.

Letërsi për fëmijë pas viteve 1990 në Shqipëri dallohet:

- A) për kujdes të veçantë ndaj gjuhës
- B) për shkujdesje ndaj normës drejtshkrimore
- C) për kulturë gjuhësore të lartë të botimeve për fëmijë
- D) për përshtatje të gjuhës me moshën e fëmijëve

Pyetja 198.

Kujt i përket vëllimi studimor “Leksikon. Shkrimtarëshqiptarë për fëmijë 1872-1995”?

- A) Robert Elsie
- B) Astrit Bishqemi
- C) Odhise Grillo
- D) Bedri Dedja

Pyetja 199.

Vëllimi studimor “Leksikon. Shkrimtarë shqiptarë për fëmijë 1872-1995” është vepër studimore me karakter:

- A) Vlerësues
- B) Informues
- C) Panoramik

D) Gjithëpërfshirës

Pyetja 200.

Cili nga këta emra nuk përfshihet në letërsinë për fëmijë në diasporë:

- A) Arshi Pipa
- B) Thoma Kacorri
- C) Thanas Jorgji
- D) Astrit Bishqemi

Pyetja 201.

Letërsia për fëmijë pas viteve 1990 ka si veçori:

- A) Liberalizimin
- B) Qëllimshmërinë
- C) Ideologjinë
- D) Ndjekjen e një metode të caktuar